


RAPORT
I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Për Programin e studimit Bachelor në “Dizajn”, ofruar nga Universiteti Privat
“Albanian University”

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

PhD. Elvan Dajko

PhD. Saimir Kristo



(Korrik/2019)

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit BSc. "Dizajn"

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Universiteti Privat "Albanian University"
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	UMASH Nr. 199, dt. 16.05.2012 VKA Nr. 319, dt. 16.03.2012
4	VBA e akreditimit të mëparshëm	VBA Nr.74, datë 21.09.2017
5	Titulli i programit të studimit:	Bachelor në Dizajn
6	Cikli i studimit:	Cikli i parë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite / 6 semestra
8	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
11	Programi ofrohet nga institucioni	Universiteti Privat "Albanian University"
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	-
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	Niveli 6
	Numri i studentëve	
16	2016-2017	29
	2017-2018	21
	2018-2019	33



HYRJE

Të dhëna për programin e studimit Bachelor në "Dizajn"

Programi i ciklit të parë të studimit, Bachelor në "Dizajn" është hapur me Urdher Nr. 199, datë 16.05.2012 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, në përputhje me VKA nr. 319, datë 16.03.2012 në Universitetin "Albania University". Ky program studimi është akredituar me kusht me Urdher Nr. 439, datë 25.08.2016 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, bazuar në Vendimin Nr. 177, datë 07.07.2016 të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë.

Akreditimin e parë ndërkohë, me vlefshmeri 2-vjeçare deri me 30/09/2019, ky program studimi e ka me Vendimin Nr.74, date 21.09.2017 të Bordit të Akreditimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë.

Programi i studimit Bachelor në "Dizajn" ofrohet nga Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, nën përgjegjësinë e Departamentit të Arkitekturës (Vendim Senati Nr. 51/2 prot., datë 09.03.2016).

Bachelor në "Dizajn" është një program i ciklit të parë i cili konsiston në 180 ECTS, dhe ka kohëzgjatje normale tre vjet me kohë të plotë, në përfundim të të cilit lëshohet diploma me emërtimin "Bachelor në Dizajn".

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ:

- 1. PhD Elvan Dajko**
- 2. PhD Saimir Kristo**

Koordinatorë Teknikë e ASCAL për këtë program studimi është Zj. Ersi Dako.

Më datë 19.07.2019, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 128/32 Prot., dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. Më datë 23.07.2019, me shkresë zyrtare me Nr. 406 Prot., Institucioni përcjell përgjigjen mbi Draft-Raportin, përmes së cilës shpreh dakordësinë me përmbajtjen e tij. Sa më lart, Draft-Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.



ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA BA NË VENDIMIN PËR AKREDITIMIN E PARË

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit:


- 1) Rekrutimi i stafit akademik me kualifikim në përputhje me lëndët/modulet specifike të programit të studimit;
- 2) Të garantohet përcaktimi i titullarëve të lëndëve me kualifikimin e duhur akademik sipas standardeve të kërkuara;
- 3) Të rritet stafi akademik efektiv për të siguruar shpërndarjen e ngarkesës mësimore nga ana sasiore dhe cilësore sipas standardeve të kërkuara.

II. Plotësimi i tyre nga Institucioni:

- 1) Për rekomandimin 1, Institucioni ka marrë hapa konkretë duke shpallur vende vakante e më tej rekrutuar pedagogë me kualifikimin në përputhje me lëndët/modulet specifike të programit të studimit (verifikuar nga materialet e DVV: “R.1 Procedurë rekrutimi v.a 2018-2019 (përpara fillimit të vitit akademik)”; “R.2 Procedurë rekrutimi v.a 2017-2018 (përpara fillimit të semestrit të dytë)”). Gjate viteve akademike 2017-2018 dhe 2018-2019, institucioni ka rekrutuar 2 pedagogë të profilit art, 2 pedagogë të profilit arkitekturë dhe 2 pedagogë të profilit gjuhësi, të angazhuar në përputhje me profilet përkatëse dhe specifikat e lëndëve (verifikuar nga materialet e DVV: “R.3 Lista e lëndëve ku angazhohen pedagogët e rekrutuar”. Nga shqyrtimi i kontratave, planeve mësimore, syllabuseve, CV-ve dhe takimet në institucion, gjykohet që ka një përputhje midis kapacitetit/eksperiencës/ekspertizës dhe lëndëve që mbulojnë stafi, duke përmbushur kështu rekomandimin.


- 2) Për rekomandimin 2, Institucioni raporton që ka hasur vështirësi në rekrutim për shkak të mungesës së pedagogëve me tituj akademik Prof. As dhe Prof. Dr. në fushen “arte” dhe “arkitekturë”. Për lëndët në të cilat ka hasur mungesë në treg të profesorëve me tituj akademik, titullarët e lëndëve janë në përputhje me Vendimin e Senatit Nr. 19/4, dt. 15.09.2017 (verifikuar nga materialet e DVV: “R.4 Vendim Senati Mbi titullarët e lëndëve”).

Ky vendim, për programet e studimit ku është gjykuar që ka mungesë në treg për pedagogeve me tituj akademik, vendos që stafi akademik i Albanian University me gradën “Doktor i Shkencave” të shërbejë si titullarë lëndësh, duke njohur karakterin e përkohshëm të këtij vendimi dhe ngarkuar njësitë bazë për vijimin e marrjes së masave për zgjidhjen e problematikës. Nga shqyrtimi i kurrikulave në proces rezulton që titullarët e 5/23 (pa diplomën dhe praktikën profesionale) të moduleve kanë kualifikim të kategorisë Prof., ndërsa pjesa tjetër ka gradën Dr. Duke marrë parasysh ciklin dhe veçorinë e programit si dhe vështirësitë objektive për gjetjen e stafin akademik me tituj në profilet specifike, pa mohuar rëndësinë e vijimit të rekrutimit të stafit me tituj si dhe stimulimin e stafit aktual për fitimin e kualifikimeve të mëtejshme, gjykojmë që rekomandimi është kryesisht i përmbushur në raport me kohën.



- 3) Për rekomandimin 3, institucioni, nga pikëpamja cilësore, gjatë viteve akademike 2017-2018 dhe 2018-2019 ka rekrutuar 5 pedagogë efektivë të angazhuar, të profilit në programin e studimit Bachelor në "Dizajn", 4 pedagogë me gradë Dr. dhe 1 MSc.

Nga pikëpamja sasiore, numri i pedagogëve të angazhuar në programin e studimit Bachelor në "Dizajn", në vitin akademik 2017-2018, është 19, ku rreth 73% e ngarkesës vjetore u mbulua nga pedagogët efektivë, ndërsa në vitin akademik 2018-2019, numri i pedagogëve të angazhuar është 14, ku rreth 74% e ngarkesës vjetore u mbulua nga pedagogët efektivë. Shpërndarja e ngarkesës mësimore të stafit akademik është në përputhje me Vendimin e Senatit Nr. 46, dt 28.09.2018 dhe Nr. 19/5, datë 15.09.2017 ku vendoset që ngarkesa mësimore e stafit akademik të jetë në përputhje me nevojat e njësive bazë përkatëse. Duke u bazuar në ngarkesat mësimore të 2017-2018, 2018-2019 dhe planin e 2019-2020, në vendimet dhe udhëzimet në fuqi për ngarkesën mësimore të stafit në IAL gjykojmë që, edhe pse mund të përmirësohet më tej pasi ka një pjesë të stafit PAE që janë me orë suplementare po brenda normave, ky rekomandim është i përmbushur nga institucioni.



ADMINISTRIMI I NJËSISË NË SHËRBIM PROGRAMIT TË STUDIMIT

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Programi i studimit Bachelor në “Dizajn” ofrohet nën përgjegjësinë e Departamentit të Arkitekturës, pranë Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike.

Programi i Studimit Bachelor në “Dizajn” është një program studimi me kohë të plotë dhe me një kohëzgjatje prej 3 vitesh akademike, me një total prej 180 ECTS.

Bazuar në materialet e DVV dhe nga takimet e zhvilluara në institucion, ky program, është në përputhje me misionin, qëllimet dhe strategjinë për zhvillim të institucionit si dhe hartimi i tij është në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe me zhvillimin e vendit, pa rënë ndesh me interesat dhe vlerat kulturore kombëtare.

Objektiva specifike të ekspozuara në rregulloren e programit të studimit janë si më poshtë:


1. Gjatë vitit të parë akademik, programi Bachelor në “Dizajn” ka si synimin t’u ofrojë studentëve njohuri të përgjithshme dhe specifike të programit, mbështetur në lëndë të formimit bazë, plotësues dhe ndërdisiplinor.
2. Gjatë dy viteve të tjera akademike, studenti thëllon njohuritë që përkojnë me profilin e diplomës Bachelor në “Dizajn”.
3. Ofrimin studentëve të njohurive të cilat lejojnë ndjekjen e cikleve pasardhëse të studimit apo vijimin e karrierës profesionale.

Këto objektiva i përgjigjen mjaft mirë nevojave dhe kërkesave të tregut. Vetë rritja e studentëve të rekrutuar sugjeron një vlerësim të dijeve, kompetencave profesionale dhe aftësive teknike dhe artistike të cilat ky program ofron. Kombinimi i njohurive teoriko-praktike justifikohet mjaft mirë në një program Bachelor në “Dizajn” për shkak të specifikave tekniko-artistike që profesioni i dizajner-it kërkon.

Kombinimi i njohurive teorike dhe praktike në fushën e dizajnit, falë lëndëve të ofruara në këtë program, plotëson më së miri qëllimin e programit në ofrimin e një formimi të gjerë në një sërë “fusha” të dizajnit duke u hapur rrugën studentëve për profilizim të mëtejshëm, si në nivel profesional dhe akademik. Njëherazi, studentëve u ofrohen dhe kompetenca më specifike, fakt i verifikuar dhe nga raporti prej 53.9 % të programit (97 ECTS) të përbërë nga lëndë karakterizuese (B) të fushës së studimit.

Siç dhe shprehet në RVB, formimi i marrë nga ky program aftëson studentët për punësim dhe angazhim profesional e akademik në nivele të ndryshme, si:

- aktivizimin në institucione, studio apo kompani të ndryshme në fushën e dizajnit;
- aktivizimin në industrinë e prodhimit dhe realizimit të punimeve në fushën e dizajnit;
- ndjekjen e niveleve të tjera të studimi Master në fushën e dizajnit apo fusha të ngjashme.



Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
I - OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit;</p> <p>Kriteri 4 Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Objektivat dhe Programi i Studimit Bachelor në “Dizajn”, bazuar në Rregulloren e vetë programit dhe në vëzhgimin e programit, janë të hartuara/zhvilluara në përputhje me vizionin dhe misionin e institucionit (Kreu II, Neni 4 i Rregullores së Programit).</p> <p>Programi i studimit synon të japë njohuri formuese të përgjithshme bazë mbi çështje të dizajnit. Duke qenë një program i ciklit të parë, objektivat formuese fokusohen në ofrimin e një formimi me bazë të gjerë por dhe në formimin e aftësive të veçanta e të specializuara në fushën e dizajnit. Kjo përjasje, referuar dhe shpërndarjes së krediteve/lëndëve ku 17.2% e tyre (31 ECTS) janë lëndë bazë (A) dhe japin një formim të përgjithshëm bazë dhe ku rreth 53.9 % të tyre (97 ECTS) lidhen me disiplina karakterizuese të fushës së studimit, u mundëson studentëve pas përfundimit të programit alternativa të mjaftueshme për thellim dhe profilizim të mëtejshëm të tyre gjatë ciklit të dytë të studimeve apo në fushën profesionale, qoftë brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>Programet hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës në fushën e dizajnit. Institucioni zhvillon studime tregu për këtë qëllim si dhe ka aktive një numër të madh marrëveshjesh bashkëpunimi me biznese të lidhura me fushën, çka lehtëson praktikat profesionale por dhe ndihmon në marrjen e inputeve në lidhje me kërkesat e tregut.</p> <p>Sikurse është ekspozuar edhe në RVB, gjykojmë që formimi i marrë nga ky program, aftëson studentët për punësim në nivele dhe punë të ndryshme si:</p> <ul style="list-style-type: none">• Studio dizajni grafik;• Studio projektim interieri;• Studio fotografike;• Galeri arti;• Studio televizive;• Shtypshkronja dhe shtëpi botuese;• Individualisht në sektor privat, etj. <p>Të gjithat fushat e mësipërme janë në një zhvillim konstant në vendin tonë dhe së fundmi vërehet dhe një rritje në industrinë e prodhimit dhe realizimit të</p>

	<p>punimeve në fushën e dizajnit, çka e bën këtë profil mjaft të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të vendit. GVJ konkludon që programi është në përputhje të plotë me zhvillimin ekonomik të vendit.</p>
--	---

Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.

<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit; Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme; Kriteri 3 Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë dhe formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh në realizimin e misionit dhe qëllimit të institucionit;</p>	<p>Në Planin Strategjik të Zhvillimit Insitucional 2017-2022 të Albanian University, evidentohet fakti që si mision ka krijimin, transmetimin, zhvillimin dhe mbrojtjen e dijes me anë të mësimdhënies, veprimtarisë kërkimore-shkencore, zhvillimin ekonomik në nivel kombëtar në fushat e specializimit të tij e në rastin konkret në atë të dizajnit më anë të programit Bachelor në Dizajn.</p> <p>Për hartimin e planeve dhe programeve mësimore janë marrë parasysh raportet ndërmjet tipeve të ndryshme të komponenteve mësimore. Kështu rreth 17.2% e tyre (31 ECTS) janë lëndë bazë (A) ndërkohë që 53.9 % të tyre (97 ECTS) janë në lëndë karakterizuese (B) të fushës së studimit. Pjesa e mbetur është ndarë 13.9% (25 ECTS) në lëndë ndërdisiplinore/ integruese (C), 10.6% (19 ECTS) në lëndë plotësuese (D) dhe 4.4 % (8 ECTS) të dedikuara për përgatitja e detyrës së diplomës (E), ku përqindja totale e lëndëve të kategorive A dhe B është 71.1 %.</p> <p>GVJ gjykon që kurrikula është organizuar në përputhje me objektivat e programit dhe formimin që synon t'i japë studentit duke ruajtur njëherazi një raport të ekuilibruar të njohurive bazë e të përgjithshme (përfshirë dhe metoda shkencore) dhe formimin e shprehive të veçanta.</p> <p>Konstatohet gjithashtu që në perfundim të programit, studentët përfitojnë njohuritë e nevojshme për të vijuar më pas studimet e tyre në programe të tjera të ciklit të dytë apo në zhvillimin e karrierës profesionale, në linjë kjo me Statutin dhe Strategjisë e Zhvillimit të Universitetit.</p>
---	--

II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE

Standardi II.1 - Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës.

<p>Kriteri 1 Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar; Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar e ndërkombëtar; kërkesat e punëdhënësve; 	<p>Dizajni përbën një fushë që mund të konsiderohet në zhvillim të vazhdueshëm. Shqipëria ka parë një rritje të eksporteve të produkteve në fushën e dizajnit, kryesisht nga aktivitete fasone (mobilje, veshje, produkte plastike, etj.) Gjithashtu një numër gjithmonë e më i madh shërbimesh bëhet "outsourcing" në Shqipëri si dizajni grafik, dizajni i</p>
---	--

<p>c. një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program;</p> <p>d. numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.</p>	<p>interierit, ëeb dizajni, etj. Mund të thuhet kështu që ky program studimi plotëson nevojat e tregut në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar.</p> <p>Institucioni zhvillon studime tregu (në DVV gjendet studimi gjatë muajve qershor-korrik 2018) me anë të të cilave Departamenti i Arkitekturës në bashkëpunim me Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave “rishikon” çdo fillim viti programet mësimore me qëllim përditësimin e tyre në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>
---	--

Standardi II.2 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.

<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimesh që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>GVJ gjykon që programi i studimit Bsc. në “Dizajn” është në përputhje me interesat kombëtare dhe ndihmon në ruajtjen dhe përforsimin e vlerave kulturore kombëtare.</p>
--	--

Konkluzionet e vlerësimit:

Në shqyrtimin tërësor të plotësimin të standardeve/kritereve për këtë rubrikë, GVJ konkludon:

1. Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion, konfirmohet që programi i studimit Bsc. në “Dizajn”, është hartuar/zhvilluar në përputhje me vizionin dhe misionin dhe strategjinë e zhvillimit të institucionit.
2. Objektivat e programit janë të qarta për formimin e studentëve, bazuar në aftësitë dhe kompetencat profesionale të fushës së studimit.
3. Programi ofron një raport të ekuilibruar të njohurive bazë e të përgjithshme (përfshirë dhe metoda shkencore) dhe formimin e shprehive të veçanta.
4. Programi është hartuar për t’ju përgjigjur tregut të punës në përputhje me nevojat e vendit në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar.
5. Programi i studimit Bsc. në “Dizajn” është në përputhje me interesat kombëtare dhe ndihmon në ruajtjen dhe përforsimin e vlerave kulturore kombëtare.


2. Struktura akademike e Fakultetit (përgjegjës për programin e studimit)

Pjesa përshkimore

Terma reference: përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike është një njësi kryesore e Universitetit Privat “Albanian University” (AU) që zhvillon procesin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor në fushat e arkitekturës, inxhinierive dhe shkencave ekonomike.

Në rregulloren e tij (Kreu II - Organizimi dhe Drejtimi i Fakultetit, Neni 7 - Organizimi i Fakultetit) përcaktohet që Fakulteti përbëhet nga autoritetet drejtuese (Dekani, Zv/Dekani,



Përgjegjësit e Departamenteve), organet drejtuese (Asambleja e Personelit Akademik, Administratori i Fakultetit), administrata dhe njësitë bazë mësimore - shkencore.

Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike përbëhet nga 3 njësi bazë mësimore - shkencore:

- 1) Departamenti i Inxhinierive;
- 2) Departamenti i Arkitekturës;
- 3) Departamenti i Shkencave Ekonomike.

Departamenti i Arkitekturës është njësi përgjegjëse për organizimin e programit Bachelor në "Dizajn".

Sipas përcaktimeve të bëra në Statutin e AU, personeli akademik i Universitetit Privat "Albanian University" përbëhet nga personeli akademik efektiv dhe personeli me kontratë. Marrëdhënia e stafit akademik me "Albanian University" përcaktohet në bazë të kontratës së punës (ku përfshihen të drejtat dhe detyrimet, pagesa, kohëzgjatja, ngarkesa, etj.), në Rregulloren e Përgjithshme të AU dhe në rregulloren e Fakultetit (Neni 19).

Në Rregulloren e Fakultetit (Neni 7, pika 5) përcaktohet dhe Personeli ndihmës-akademik i Fakultetit si më poshtë:

- Personet ndihmës-akademik me karakter administrativ (Kryesekretarja e Sekretarisë Mësimore dhe Sekretaret e Sekretarisë Mësimore);
- Personel ndihmës-akademik me karakter mësimor (Asistentët e Departamenteve, Laborantët dhe Asistent pedagogët e praktikave mësimore).

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Struktura akademike e Fakultetit (*Tabela 1 e Anekseve*)

Bazuar në strukturën akademike, organigramën dhe të dhënat e stafit akademik, Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike në AU ka aktualisht 96 pedagogë gjithsej, nga të cilët 51 janë Personel Akademik Efektiv dhe 45 Personel Akademik me Kontratë, dhe ka gjithashtu dhe 27 Personel Administrativ. Në vitin akademik 2017-2018, Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike në AU ka patur 122 pedagogë gjithsej, nga të cilët 67 janë Personel Akademik Efektiv dhe 55 Personel Akademik me Kontratë, dhe ka patur gjithashtu dhe 21 Personel Administrativ.

Në nivel departamentesh, numri i personelit, **për vitin akademik 2017-2018**, paraqitet si më poshtë (*Tabela 2 dhe 3 e Anekseve*):

1. Departamenti i Inxhinierive: 23 Personel Akademik Efektiv, 14 Personel Akademik me Kontratë dhe 12 Personel Administrativ;
2. Departamenti i Arkitekturës: 21 Personel Akademik Efektiv, 19 Personel Akademik me Kontratë dhe 10 Personel Administrativ.
3. Departamenti i Shkencave Ekonomike: 23 Personel Akademik Efektiv, 22 Personel Akademik me Kontratë dhe 11 Personel Administrativ.

Në nivel departamentesh, numri i personelit, **për vitin akademik 2018-2019**, paraqitet si më poshtë (Tabela 2 dhe 3 e Aneksëve)::

1. Departamenti i Inxhinierive: 19 Personel Akademik Efektiv, 16 Personel Akademik me Kontratë dhe 13 Personel Administrativ;
2. Departamenti i Arkitekturës: 10 Personel Akademik Efektiv, 8 Personel Akademik me Kontratë dhe 11 Personel Administrativ.
3. Departamenti i Shkencave Ekonomike: 22 Personel Akademik Efektiv, 22 Personel Akademik me Kontratë dhe 11 Personel Administrativ.

Të dhëna për Stafin akademik të Departamentit përgjegjës (Tabela 2 dhe 3 e Aneksëve):

Departamenti i Arkitekturës, si njësi bazë ku zhvillohet programi Bachelor në “Dizajn”, për vitin akademik 2018-2019 ka në përbërje të tij 10 PAE, me kualifikimin: 1 Prof.As.Dr., 5 Dr. dhe 4 Msc., dhe 8 PAK, me kualifikimin: 1 Prof. Dr., 5 Dr., 1 Drnt. dhe 1 Msc., duke plotësuar standardet sa i përket numrit dhe kualifikimit të stafit.

Mbështetur në të dhënat e sjella me DVV, në vitin akademik 2017-2018, Departamenti i Arkitekturës përbëhej nga 21 PAE, me kualifikimin: 1 Prof. Dr., 1 Prof.A s., 7 Dr., 2 Drnt., dhe 10 Msc. dhe 19 PAK, me kualifikimin: 4 Prof.As., 10 Dr., 4 Drnt., dhe 1 Msc. Arsyeya e uljes së stafit është mbyllja e programit të studimit në Arkitekturë.

Përsa i përket balancës gjinore, për vitin akademik 2018-2019, raporti M/F është 7/11, ndërsa në vitin akademik 2017-2018, raporti M/F ka qenë 21/19.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Dokumentacioni i verifikuar në vizitat në institucion qëndron korrekt me dokumentacionin e DVV-së të institucionit si dhe të dhënat e deklaruara nga Institucioni në Raportin e Vleresimit të Brendshëm (RVB) mbi treguesit e mësipërm.

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DVV dhe nga vizita në institucion, GVJ konstaton që ka një balancë mjaft të mirë ndërmjet stafit me eksperiencë dhe atij më të ri. Raporti pedagog/studentë për këtë program studimi është afërsisht 1:4, gjë që mundëson një ndërveprim mjaft të mirë, e konfirmuar kjo dhe nga vetë studentët.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat (Tabela 4 e Aneksëve):

GVJ, përmes shqyrtimit të dokumentacionit të DVV-së dhe vizitës në institucion, konstaton që raporti PAE/PAK është komform me raportimin e kryer nga institucioni dhe RVB.

Nga verifikimet e bëra në programin e studimit Bachelor në "Dizajn", personeli akademik në këtë program përbëhet nga 14 personel akademik në total, prej të cilëve 8 janë personel akademik me kohë të plotë dhe 6 personel akademik me kontratë. Bazuar në dhënat e programit mësimor, rezulton që stafi akademik me kohë të plotë përbën afërsisht 74% të orëve në auditor në këtë program studimi.

Për vitin akademik 2017-2018 dhe vitin aktual akademik 2018-2019, referuar të dhënave të paraqitura në DVV dhe RVB, stafi akademik i programit paraqitet si më poshtë:

Viti akademik 2017 – 2018: 11 PAE dhe 8 PAK

11 PAE - 1 Prof. Dr; 5 Dr; 5 MSc;

8 PAK - 1 Prof. As. Dr; 5 Dr; 1 Drnt; 1 MSc.

Viti Akademik 2018 – 2019: 8 PAE dhe 6 PAK

8 PAE - 4 Dr; 4 MSc;


6 PAK - 1 Prof. Dr; 4 Dr; 1 Msc.

Vërehet që numri i pedagogëve në terësi është ulur nga 19 në vitin akademik 2017-2018 në 14 në vitin akademik 2018-2019. Shpërndarja e ngarkesës mësimore të stafit akademik është në përputhje me Vendimin e Senatit Nr. 46, dt. 28.09.2018 dhe Nr. 19/5, dt. 15.09.2017 ku vendoset që ngarkesa mësimore e stafit akademik të jetë në përputhje me nevojat e njësive bazë përkatëse, megjithatë sugjerohet që njësia bazë të përkujdeset të mbajë nën monitorim të vazhdueshëm ngarkesën e stafit, kryesisht në kushtet ku angazhimi i të njëjtit staf mund të angazhohet dhe në Masterin Profesional në "Interier Dizajn". Përsa i përket stafit, bazuar në lëndët që japin, syllabuset dhe CV e tyre gjykohet që ka një përputhje midis kapacitetit/eksperiencës/ekspertizës dhe lëndëve që mbulojnë.

- Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre (Tabela 5 e Aneksëve):

Për vitin akademik 2018-2019, nga stafi i angazhuar në programin e studimit, 1 është me titull Prof. Dr., (në një raport PAE/PAK 0/1), 8 me gradën shkencore Doktor (në një raport PAE/PAK 4/4), dhe 5 me gradë shkencore MSc. (në një raport PAE/PAK 4/1). I gjithë personeli i angazhuar në mësimdhënie ka së paku kualifikimin e ciklit pasardhës, ndërkohë që bie në sy një mungesë e gradave Prof. Dhe Prof. As, siç dhe është raportuar nga Institucioni për shkak të mungesës së tyre në përgjithësi në treg për shkak të profilit shumë specifik të programit.

Për vitin akademik 2017-2018, nga stafi i angazhuar në programin e studimit, 1 është me titull Prof. Dr., (në një raport PAE/PAK 1/0), 1 me titull Prof. As., (në një raport PAE/PAK 0/1), 10 me



gradën shkencore Doktor (në një raport PAE/PAK 5/5), dhe 7 me gradë shkencore MSc. (në një raport PAE/PAK 5/2).

Të dhënat sipas seksit

Shpërndarja gjinore e stafit të angazhuar në programin e studimit Bachelor në "Dizajn" tregon një balancë gjinore shumë të mirë falë një raporti F/M 8/6, për vitin akademik 18-19 dhe raporti F/M 11/8, për vitin akademik 17-18. Stafi me gradën Prof. është i gjinisë mashkullore, ndërkohë që stafi me gradën Dr. anon pothuajse i gjithi nga gjinia femërore, çka nënkupton që me fitimin e titujve pasues akademik pritet që balanca e titujve Prof. të kalojë nga ana e gjinisë femërore.

Të dhëna sipas moshës së personelit (*Tabela 6 e Aneksve*):

Nga pikëpamja moshore, vihet re që stafi i angazhuar në programin e studimit Bachelor në "Dizajn" ka një shpërndarje mjaft të ekuilibruar dhe pothuajse të njëtrajtshme. Për vitin akademik 18-19, për stafin PAE, mbizotëron lehtësisht moshja 56-65 vjeç duke pasur 3/8 ndërkohë që për PAK mbizotëron lehtësisht moshja 36-45 vjeç duke patur 2/4. Për vitin akademik 17-18, për stafin PAE, mbizotëron lehtësisht moshja 25-35 dhe 36-45 vjeç duke pasur secila grupmoshë 3/11 ndërkohë që për PAK mbizotëron lehtësisht moshja 25-35 vjeç duke patur 3/8.

Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Nga shqyrtimi i materialit të DVV dhe vizitës në institucion (në zyrën e Burimeve Njerëzore), GVJ konstaton se AU për rekrutimin e stafit plotëson standardet sipas Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe Kodit të Punës.

Nga verifikimet e bëra, kontratat e stafit akademik me kohë të plotë për të gjitha kategoritë profesor/lektor/asistent lektor janë me afat të pacaktuar, ndërsa kontratat e stafit akademik me kontratë, për kategoritë profesor dhe lektor janë me afat të pacaktuar, ndërsa për kategorinë asistent-lektor janë me afat të caktuar.


Institucioni ka një arkivë të plotë me dosjet e rekrutimit, dokumentat e nevojshme për çdo staf dhe kontratat e punës dhe anekset përkatëse ku saktësohen të gjitha të drejtat dhe detyrimet e palëve si dhe angazhimi dhe ngarkesa e saktë për çdo pedagog.

Cilësia e stafit ndihmës/administrativ për çdo njësi bazë

GVJ konstaton përmes vizitës në institucion që institucioni angazhon një staf ndihmës/administrativ cilësor dhe të mjaftueshëm për të garantuar një funksionim cilësor të procesit akademik.

Për vitin akademik 18-19, raporti Personel akademik/Personel ndihmës-akademik me karakter mësues/Personel ndihmës-akademik me karakter administrativ/student për programin e studimit është 14/ 1/7 / 76.

Për vitin akademik 17-18, raporti Personel akademik/Personel ndihmës-akademik me karakter mësues/Personel ndihmës-akademik me karakter administrativ/student për programin e studimit është 19/1/7/61.



Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

GVJ-së ju vunë në dispozicion materiale nga dosjet e personelit si procese rekrutimi, materialet dokumentare si CV, dëshmi të ndryshme, kontrata, anekse kontratash, etj.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
III - PERSONELI I INSTITUCIONIT	
Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë, etj.</p>	<p>AU, për rekrutimin e stafit, ndjek procedura ligjore dhe transparente dhe plotëson standardet sipas Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe Kodit të Punës.</p> <p>Në fillim të çdo viti akademik, njësitë bazë, bazuar në nevojat e tyre, i paraqesin Dekanatit kërkesat për plotësimin e vendeve vakante. Dekani i Fakultetit ia përcjell keto kërkesa Rektoratit, i cili përcakton kriteret e pranimit dhe procedurat e konkurrimit. (Neni 19, pika 3, Rregullore Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike).</p> <p>Ndjekja dhe respektimi i këtyre procedurave është verifikuar drejtpërdrejtë gjatë vizitës në Institucion në takimin me Drejtuesit e Njësive, me vetë Stafin Akademik dhe në takimin me Zyrën e Burimeve Njerezore ku janë kërkuar dhe parë dosjet dhe procesverbalet e rasteve konkrete të rekrutimit të stafit.</p> <p>Për vitin akademik 2017-2018, 73% e orëve në auditor mbulohen nga personeli akademik efektiv, kurse në vitin 2018-2019, 74% e orëve në auditor mbulohen nga personeli akademik efektiv.</p> <p>Nga shqyrtimi i ngarkesave mësimore të raportuara të vitit 2017-2018 rezulton që për stafin ka një ngarkesë mësimore që shkon nga 15 orë vjetore në 240 orë. Rezultojnë vetëm 5 anëtarë të stafit PAE që kanë orë suplementare por brenda normave të udhëzimeve. Përsa i përket numrit të lëndëve, varion nga 1 lëndë semestrare (për të gjithë PAK) deri në një rast të vetëm PAE që ka 1 lëndë vjetore dhe 2 semestrare. Në përgjithësi për PAE vërehet që kanë 2 module semestrare.</p> <p>Për vitin 2018-2019 rezulton që për stafin ka një ngarkesë mësimore që shkon nga 37 orë vjetore në 383.5 orë. Rezultojnë 5 anëtarë të stafit PAE që kanë orë suplementare por brenda normave të udhëzimeve.</p>

	<p>Përsa i përket numrit të lëndëve për PAE varion nga 1 lëndë semestrale deri në 1 lëndë vjetore dhe 2 semestrale. Në përgjithësi për PAE vërehet që kanë 2-3 module semestrale. Vërehet një rritje e ngarkesës në krahasim me 17-18, dhe pse brenda normave të udhëzimeve, por që nga plani i 2019-2020 i vënë në dispozicion shihet që ulet në mënyrë të qenësishme kjo ngarkesë, edhe pse në disa raste me orë suplementare duket afër ngarkesave normale pa orë suplementare. Duke u bazuar në dokumentacionin në lidhje me ngarkesën vjetore të përcjellë nga IAL, ngarkesa në orë dhe numër lëndësh të stafit akademik është në përgjithësi në përputhje me udhëzimet për ngarkesën mësimore në IAL.</p> <p>Procesi i rekrutimit të institucionit është transparent me aplikantët në të gjitha fazat e tij. Informacioni është publik dhe i shpallur online. Komisionet e posaçme të ngritura për vlerësimin ndjekin gjithashtu procedura transparente.</p> <p>Zyra e Burimeve Njerezore mban një bazë të dhënash, hard copy dhe elektronike, të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë, kontratat e firmosura, dokumentacionin ligjor të dorezuar, etj.</p>
--	--

Standardi III.2 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.

<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni angazhon si titullarë të lëndëve/moduleve për programet e studimeve të ciklit të parë, personel akademik që ka së paku gradën shkencore “Doktor., ose titullin akademik “Docent,...</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion konstaton që Zyra e Burimeve Njerezore disponon një bazë të dhënash të hollesishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit.</p> <p>Gjithashtu, në dosjet e personelit, ndodhen këto të dhëna:</p> <ul style="list-style-type: none"> - CV; - Dokumente identifikimi (Pasaportë ose ID); - Fotografji; - Diplomë e noterizuar e studimeve universitare; - Transkripti i noterizuar i lëndëve dhe notave të studimeve universitare; - Diploma e noterizuar e Titullit Akademik (Prof., Prof. As., Dr, Docent) (kur aplikohet); - Diplomë e noterizuar e studimeve pasuniversitare (kur aplikohet); - Licencën Profesionale (kur aplikohet); - Certifikata apo dëshmi të ndryshme (kur ka); - Librezë Shëndetësore dhe Raport mjeko-ligjor; -Etj.
--	---




	<p>Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ.</p> <p>Kriteret e publikimit dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik janë informacione që shpallen nga Zyra e Burimeve Njerezore pranë AU dhe online në faqen web të Univesitetit.</p> <p>Për lëndët në të cilat ka hasur mungesë në treg të profesorëve me tituj akademik, titullarët e lëndëve janë në përputhje me Vendimin e Senatit Nr. 19/4, dt. 15.09.2017. Ky vendim, për programet e studimit ku është gjykuar që ka mungesë në treg për pedagogë me tituj akademik, vendos që stafi akademik i Albanian University me gradën “Doktor i Shkencave”, të shërbejë edhe si titullarë lëndësh, e implementuar në rastin e Bachelor në “Dizajn”.</p>
--	---

Standardi III.3 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.

<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni vë në dispozicion personel të mjaftueshëm për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale (së paku 1 tutor/instruktor për 12 studentë).</p>	<p>Institucioni dëshmon që ka një angazhim mjaft të mirë të personelit ndihmës për mbarëvajtjen e orëve laboratorike dhe në mirëmbajtjen e ambjenteve të zhvillimit të aktivitetit akademik.</p> <p>Institucioni ka një staf të dedikuar administrativ i cili mundëson përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë. Për vitin akademik 18-19, raporti Personel akademik/Personel ndihmës-akademik me karakter mësimor/Personel ndihmës-akademik me karakter administrativ është 14/ 1/7, ndërsa në vitin akademik 17-18 ka qenë 19/1/7.</p> <p>Praktikat profesionale në programin e studimit Bachelor në “Dizajn” zhvillohen nën kujdesin e një pedagogu i cili shërben si koordinator i atij procesi. Në këtë mënyrë garantohet ndihma dhe orientimi i një eksperti të fushës mbi të cilën studentët po zhvillojnë praktikën profesionale. Pjesa më e madhe e studentëve rezulton se kryen praktikat profesionale në institucione/biznese me të cilat AU ka marrëveshje bashkëpunimi. Në vitin e fundit, bazuar në raportet dhe analizat e Departamentit, rezulton se studentët ishin të shpërndarë në 10 institucione/biznese nga 26 më të cilat AU ka marrëveshje bashkëpunimi. Nga takimi me studentët është verifikuar efektshmëria e këtij procesi.</p>
--	---

Standardi III.4 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.



Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor;

Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash të programeve të studimeve të ofruara.

Institucioni nuk organizon momentalisht programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.

Ndërkohë nga takimi me njësitë në institucion, rezulton që AU ka aplikuar në MASR për hapjen një programi të ciklit të tretë tek i cili, në rast miratimi, mund të kenë akses dhe pedagogët e këtij departamenti (*"Standardizimi: Integrimi European, Transferimi i Teknologjise dhe Inovacion"*, pranë Departamentit të Inxhinierive, Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, në Albanian University).

Të gjitha të dhënat e programeve të studimeve të ofruara disponohen si në hard copy edhe elektronikisht, pranë Departamenteve përkatëse dhe Zyrës për Zhvillimin e Kurrikulave.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. AU për rekrutimin e stafit ndjek procedura ligjore dhe transparente dhe plotëson standardet sipas Ligjit Nr. 80/2015 *"Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"* dhe Kodit të Punës.
2. Për vitin akademik 2017-2018, 73% e orëve në auditor mbulohen nga personeli akademik efektiv, kurse në vitin 2018-2019, 74% e orëve në auditor mbulohen nga personeli akademik efektiv.
3. Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personelit përgjegjës për organizmin e programit të studimit. Informacioni i plotë që nga momenti i procesit të rekrutimit e deri te kontrata me dokumentacionin përkatës, ruhet pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore.
4. Për lëndët në të cilat ka hasur mungesë në treg të profesorëve me tituj akademik, titullarët e lëndëve janë në përputhje me Vendimin e Senatit Nr. 19/4, dt. 15.09.2017. Ky vendim, për programet e studimit ku është gjykuar që ka mungesë në treg për pedagogë me tituj akademik, vendos që stafi akademik i Albanian University me graden "Doktor i Shkencave" të shërbejë edhe si titullarë lëndësh, e implementuar në rastin e Bachelor në "Dizajn". Duke njohur karakterin e përkohshëm të këtij vendimi, janë ngarkuar njësitë bazë për vijimin e marrjes së masave për zgjidhjen e problematikës.
5. Moduli i praktikës profesionale ka një udhëheqës specifik i cili drejton procesin në koordinim me studentët si dhe institucionin partner në të cilin studenti kryen praktikën mësimore.

4. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

Ndërtesa e dedikuar Departamentit të Arkitekturës, akomodon nevojat e programit të studimit Bachelor në "Dizajn". Pas rikonstruksionit të saj, ajo ofron mundësinë e sallave të leksioneve,

seminareve, laboratorëve në funksion të programit të dizajnit. Infrastruktura e auditorëve si dhe laboratorëve është e përshtatshme për zhvillimin e programit të studimit duke konsideruar gjithashtu dhe bibliotekën e cila përbën një hapësirë shtesë studimi për studentët, por dhe stafin akademik. Gjatë vizitës u verifikuan të gjitha mjediset në dispozicion të programit.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Infrastruktura e ofruar nga AU për të realizuar programin e studimit Bsc në “Dizajn” në të gjithë komponentët e saj dhe sipas standardit të kërkuar plotëson nevojat e studentëve si dhe të pedagogëve duke garantuar mbarëvajtjen e procesit mësimor.

Mjediset për Programin e studimit (*Tabela 7 e Aneksëve*):

- Salla për leksione
- Klasa për seminare
- Salla për aktivitete promovuese
- Salla për praktikë lëndore/ profesionale
- Laboratorë për lëndët
- Laboratorë informatike
- Salla interneti
- Salla për bibliotekë
- Mjedis për fotokopjime, librari etj
- Zyra informacioni për studentët
- Nyje hidrosanitare

Në bazë të RVB rezulton 4.7 m2/person (student) nëse do të merret që 2184.99m2 ambjente për studentët do të shfrytëzohen nga 465 studentë njëherazi (Bsc Inxhinieri dhe Bsc Dizajn).

Mjediset për stafin (*Tabela 7 e Aneksëve*):

- Mjediset për Dekanin/ kancelarin
- Zyra për sekretarinë mësimore
- Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore
- Zyra për personelin akademik

Në bazë të RVB raportohen 4.25m2/person (staf).

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Janë vizituar dhe verifikuar ambjentet e raportuara në RVB.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
V - INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI	
Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	
Kriteri 1 Institucioni vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në sasi dhe cilësore;	Institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve tekstet mësimore dhe literaturën ndihmëse të

Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit;

Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe programe kompjuterike, si libraritë elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit;

Kriteri 4 Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për të;

Kriteri 5 Biblioteka shpall oraret e shërbimit në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve.

nevojshme për të zhvilluar procesin e mësimdhënies. Sugjerohet nga GVJ të shtohet literatura e dhënë duke pajisur bibliotekën me tituj të cilët i përgjigjen specifikave të lëndëve apo temave që trajtohen në programin e studimit BSc. në “Dizajn”. Numri prej 252 titujve që aktualisht biblioteka disponon duhet të zgjerohet përmes një procesi të thelluar hulumtimi në stafin akademik duke hapur një thirrje periodike të përvitshme për stafin e angazhuar në programin e studimit dhe duke u bazuar Syllabusve të lëndëve të Bsc. në Dizajn, e cila përmes miratimit të Zyrës së Kurrikulës dhe Departamentit do gjenerojë një listë të përvitshme titujsh që do i shtohen bibliotekës në funksion të stafit akademik dhe studentëve.

Duke u përgjigjur në nevojat e një programi studimi i cili është mjaft dinamik dhe në zhvillim të vazhdueshëm, sugjerohet pasurimi dhe anëtarësimi i bibliotekës me revista periodike apo online të cilat i përkasin specifikës së fushës së dizajnit dhe të gjitha lëndëve të programit të studimit. Shembuj mund të jenë Beaux Arts, Wallpaper, Design, etj.

Oraret e shpallura nga biblioteka janë në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve.

Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë dhe mjedise të përshtatshme mësimore dhe për formimin praktik.

Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;

Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;

Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve;

Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator.

Kriteri 5 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve, disponon kompjutera në laboratorët e teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale si programe për statistikë, linguistikë, arkitekturë, inxhienieri, ekonomi, mjekësi, programstimulimi për shkencat sociale etj.

Kriteri 6 Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme për zhvillimin e praktikave profesionale.

Laboratorët e integruar të programit të studimit të ofruar nga institucioni janë në numër dhe sasi të mjaftueshme. Më konkretisht 2 Laboratorët e Informatikës dhe 3 Salla të Praktikës të fokusuara në teknikat e pikturës, kaligrafisë, printmaking dhe multimedias.

Mjediset mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie, në përputhje me qëllimet e programit të studimit BSc në “Dizajn”.

Aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve që përmbajnë laboratorët janë të përshtatshme.

Institucioni ka ofruar një laborator ndërdisiplinor, i cili krijon mundësinë e zhvillimit të lëndëve të ndryshme të disa disiplinave në fushën e dizajnit, duke e pajisur me kompjuterat e nevojshëm dhe programet përkatëse për të zhvilluar modulet e ndryshme akademike.

Institucioni ka zhvilluar një sërë marrëveshesh bashkëpunimi në kuadër të praktikave profesionale me studio grafike, kompani dhe biznesesh në fushën e

multimedias, dizajnit apo komunikimit për të zgjeruar dhe përmirësuar vazhdimisht angazhimin e studentëve në praktikën profesionale. Institucioni ka si qëllim të vazhdueshëm përmirësimin e praktikave profesionale duke rritur dhe nivelin e marrëveshjeve dypalëshe me aktorë të ndryshëm në tregun e punës.

Konkluzione të GVJ:

1. Departamenti i Arkitekturës zhvillon të gjitha aktivitetet në godinën pranë Rr. së Kavajes duke akomoduar nevojat e studentëve të programit të studimit Bachelor në "Dizajn". Pas rikonstruksionit të saj ajo ofron mundësinë e sallave të leksioneve, seminareve, laboratorëve në funksion të programit të Dizajnit. Infrastruktura e auditorëve si dhe laboratorëve është e përshtatshme për zhvillimin e programit të studimit, duke konsideruar gjithashtu dhe bibliotekën, e cila përbën një hapësirë shtesë studimi për studentët por dhe stafin akademik.
2. Studentëve u janë vënë në dispozicion një sërë titujsh të literaturës përmes bibliotekës së institucionit por dhe bibliotekave online, por, nevojat specifike të programit të studimit dhe zhvillimi i vazhdueshëm i natyrës së këtij profesioni kërkon përditësimin e vazhdueshëm të kapaciteteve duke përditësuar vazhdimisht jo vetëm arkivën e bibliotekës, por edhe duke u abonuar në periodikë të fushave specifike të dizajnit.

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Terma reference: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Burimet e financimit të programit të studimit Bachelor në "Dizajn" janë thuajse totalisht nga tarifat e shkollimit dhe një pjesë shumë e vogël nga aktivitete të tjera. Këto të ardhura përdoren përgjithësisht për pagesat e stafit dhe qeranë dhe mirëmbajtjen apo përmirësimin e hapësirave të përgjithshme të institucionit.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (**në përqindje**) (Tabela 8 e Aneksëve):


Për vitin akademik 2017-2018:

- Tarifat për dhe gjatë shkollimit 99.9 %;
- Të tjera 0.1 %.

Për vitin akademik 2018-2019:

- Tarifat për dhe gjatë shkollimit 99.93 %;
- Të tjera 0.07 %.

- Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)




Shpenzimet lidhen kryesisht me fondin e pagave, kontribute për sigurime shoqerore dhe shëndetësore, honorare, aktivitete, etj. Nga RVB rezulton që rreth 33% e shpenzimeve lidhet me qiranë dhe mirëmbajtjen e ambjenteve (Tabela 8 e Anekseve).

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Nga vizita në institucion janë parë raportet financiare dhe auditimet. Nuk janë marrë kopje, thjesht janë verifikuar.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.5 - Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen e tij financiare.	
<p>Kriteri 1 Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm ose të brendshëm) të situatës financiare të tij;</p> <p>Kriteri 2 Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative, etj;</p> <p>Kriteri 3 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Institucioni kryen një audit të përvitshëm nga një kontabël i miratuar dhe i regjistruar për situatën financiare mbi bilancin e çdo viti kalendarik.</p> <p>Raporti i auditit është në komform me standardet e vendosura.</p> <p>Raporti i auditit përmban një pasqyrë të hollësishme referuar bilancit për të ardhurat dhe shpenzimet. Një fenomen që vërehet është dhe numri i vogël i projekteve apo programeve ndërinstitucionale në nivel kombëtar apo europian, duke mosdiversifikuar kështu dhe të ardhurat e institucionit.</p>
VI - BURIMET FINANCIARE DHE VLERËSIMI FINANCIAR	
Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport financiar që përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni dëshmon një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe së ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>Nga institucioni hartohet një raport financiar që përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare. Gjithashtu dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike.</p> <p>Institucioni dëshmon një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>
<u>Konkluzionet e vlerësimit:</u>	
<ol style="list-style-type: none"> 1. Grupi i vlerësimit konstatoi së AU ka një auditim të përvitshëm (të jashtëm) të situatës financiare. 2. Gjithashtu, institucioni dëshmon një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit Bachelor në "Dizajn", duke vërejtur gjithashtu dhe numrin e studentëve hyrës në rritje. 	



6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Terma reference: institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

AU ka themeluar Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë në vitin 2009-2010. Me Vendim të Senatit Akademik Nr. 178 dt. 23/07/2010, është ngritur Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë duke e përditësuar dhe në përputhje me ligjin 80/15 me Vendim Nr. 4 të Senatit Akademik dt. 22/12/2016, duke ngritur dhe Komisionin e Përhershëm për Vlerësimin Institucional, për të hartuar politikat e sigurimit të cilësisë në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë dhe Standardet Shtetërore të Cilësisë, shprehur edhe në Statutin e AU (Kreu II, neni 65, 66 dhe 67).

Kjo njësi akseson të gjitha të dhënat e Universitetit dhe, duke përdorur politika dhe kriteret e përshtatshme, garanton cilësinë institucionale. Duke qenë në varësi të drejtpërdrejtë të Rektorit të Universitetit, njësi harton dhe prezanton një raport vjetor i cili përfshin informacione dhe vlerësime për mësimdhënien, kërkimin shkencor, cilësinë e shërbimit akademik dhe administrativ dhe rekomandon masa për përmirësimin e parametrave të cilësisë në të ardhmen.

Të dhëna mbi përbërjen e NjSBC-së paraqiten në tabelën 9 të Anekseve.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:

Para përfundimit të çdo semestri realizohen anketimet për çdo pedagog/lëndë. Këto anketime bëhen duke plotësuar formularë anonim. Pra, anketimet realizohen 2 herë në vit.

Sipas raportimeve në RVB, gjatë vitit akademik 2017-2018, kanë marrë pjesë 60% e studentëve, ndërkohë që në semestrin e parë të 2018-2019 kanë marrë pjesë 76 % e studentëve. Pjesëmarrja e studentëve nuk është me detyrim. Rezultatet përpunohen dhe dorëzohen në instancat përkatëse (Njësi bazë, Njësi kryesore, Rektorat dhe diskutohet në Senat Akademik) në formë raportesh si dhe i bëhet me dije çdo pedagogu.

Kontrolli i brendshëm i cilësisë

Të gjitha funksionet e NjSBC janë parashikuar në nenin 14 të Rregullores së brendshme të Universitetit, si dhe në Rregulloret specifike për sistemin e Sigurimit të Cilësisë.

Kjo njësi ushtron një funksion mbështetës, këshillues, bashkërendues dhe monitorues duke ofruar ekspertizë në zhvillimin e proceseve të sigurimit të cilësisë.

Politikat e vetëvlerësimit dhe përcaktimi i kriterëve të vlerësimit që do të zbatohen nga institucioni hartohen bashkë me Komisionin për Vlerësim Institucional, duke hartuar në këtë mënyrë dhe anketime apo modele të raporteve vlerësuese. I gjithë procesi nga hartimi i pyetësorëve e deri te përpunimi, raportimi dhe ndjekja e masave përkatëse bashkërendohet nga kjo njësi.

GVJ konstaton që ky proces bëhet në bazë të të dhënave statistikore të mbledhura përmes anketimeve të studentëve, fokus-grupeve, raporteve të vetëvlerësimit të pedagogëve (në fund të semestrit në një vend të posaçëm të syllabusit në fund) dhe raporteve semestrale apo vjetore që hartohen në njësitë bazë por dhe rezultateve të studentëve. Në fund të procesit, evidentohen problematika apo çështje që duhen përmirësuar më tej.

Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti

NjSBC vepron gjithashtu edhe në nivel njësie bazë prej vitit 2016 me ngritjen e grupeve të Sigurimit të Cilësisë brenda tyre me Vendim Senati Akademik Nr. 157/3 dt. 08/09/2016. Në këtë mënyrë në çdo fillim viti akademik, gjatë procesit të mësimdhënies dhe në përfundim të tij, analizon dhe vlerëson programet mësimore, literaturën dhe format e vlerësimit.

Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

AU zhvillon dy anketime në vit në bazë semestri me studentët, përpara përfundimit të javëve mësimore dhe fillimit të sezonit të provimeve të dimrit dhe verës, në mënyrë për të garantuar mbarëvajtjen e procesit. Në fund të procesit bëhen raporte semestrale apo vjetore ku evidentohen problematika apo çështje që duhen përmirësuar më tej, të cilat raportohen dhe diskutohen në instancat më të larta të institucionit.

Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike


Procesi i vlerësimeve periodike është me rëndësi për institucionin si një proces i cili në mënyrë holistike vlerëson performancën e shërbimeve akademike dhe atyre administrative. Duke e konsideruar si një proces 360 gradë, ku vlerësimi ndodh përmes vlerësimit të studentëve, “vetëvlerësimit” (në formë reflektimi në fund të lëndës të syllabusit) por dhe vlerësimit nga drejtuesit (që masin dhe performancën/kontributin në kërkim), duke gjeneruar kështu analiza dhe reflektime përmes disa treguesve, siç është analiza SWOT apo dhe masa të ndërmarra për përmirësim (evidentuar në raportet semestrale dhe vjetore të Departamentit të Arkitekturës si anekse të DVV) duke mundur kështu ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë në mënyrë të qëndrueshme.

Gjatë vizitës së GVJ dhe takimeve me personelin akademik, studentët por dhe NjSBC, është evidentuar një proces pozitiv dhe konstruktiv për të zgjidhur apo ndërmarrë masa të ndryshme me qëllim përmirësimin e cilësisë së funksionimit të institucionit.

Një nga rastet konkrete qëndron dhe tek fakti i komunikimit të Syllabusit të çdo lënde përgjatë javës së parë mësimore, ku studentët kanë mundësinë për të sugjeruar apo dhënë mendimin e tyre me qëllim përmirësimin e procesit mësimor. Gjithashtu, edhe bisedat që kryhen ndërmjet stafit akademik dhe studentëve apo fokus grupeve, të cilat në mënyrë kritike dhe konstruktive kanë për qëllim përmirësimin e Syllabusit apo dhe mbarëvajtjes së orës mësimore/akademike.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE Standardi II.3 - Institucioni, për akreditimin e programeve të studimeve, përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e tyre.	
Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve; Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional; Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë; Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit,	Në fund të çdo semestri akademik përgatitet raporti i rezultateve të studentëve si dhe të anketave me studentët (“Raporti semestral i Departamentit të Arkitektures per v.a 2018-2019” në DVV). Këto raporte i parashtrohen institucionit nga njësia bazë. Në përfundim të semestrit të dytë përfundon dhe



<p>përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta:</p> <p>Të tërthorta:</p> <ol style="list-style-type: none"> Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve; Sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit; Pyetje konceptuale; Intervista; Etj. <p>Të drejtpërdrejta:</p> <ol style="list-style-type: none"> Teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara); Dëgjime në auditor; Vlerësimi me nota/pikë; Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë; Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët (detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, provimet, referatet); Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës; Etj. 	<p>hartimi i raportit të plotë vjetor i cili përmban një analizë më të plotë dhe krahasimore të të gjithë të dhënave të marra përmes procesit të vetëvlerësimit. ("Raporti vjetor i Departamentit të Arkitektures për v.a 2017-2018" në DVV).</p> <p>GJV konstaton se të gjitha rezultatet e arrira por dhe synimet e institucionit publikohen në mënyrë transparente, siç publikohen dhe metodologjitë e tërthorta apo të drejtpërdrejta përmes sondazheve të studentëve, stafit, të diplomuarve, diskutimeve ndërmjet zyrës së kurrikulave me përfaqësinë studentore, takimeve midis stafit akademik dhe studentëve si dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë, përmes dëgjimeve në auditor, vlerësimeve në mënyrë pikësore, testeve paraprake apo përfundimtare, praktikave, prezantimeve dhe vlerësimet e lëndëve dhe detyrave, etj.</p>
---	--

VIII - INSTITUCIONI GARANTON SIGURIMIN E CILËSISË

Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.

Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;

Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;

Kriteri 3 Institucioni harton një politikë të qartë dhe ndjek procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron;

Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve që ofron;

Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;

Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.

GJV konstaton se AU ka plotësuar standardet institucionale për të aplikuar për akreditimin e programit.

Instrumentat e përdorura nga AU janë në përputhje me kuadrin e përcaktuar ligjor dhe të përshtatshme për specifikën e llojit të programeve të studimit që ofrohen.

Politikat e hartuara nga Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë së Albanian University janë të qarta dhe ndjekin procedura periodike dhe efikase për të garantuar cilësinë dhe standardet e programeve të ofruara.

Të gjithë mekanizmat e AU për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve janë transparente, me instrumenta formal për të garantuar procesin. AU është një institucion i vetëdijshëm për rëndësinë e cilësisë në tërësi të institucionit, fakt ky i konstatuar përmes DVV si dhe vizitës së GJV në institucion dhe bisedat apo takimet me të gjitha njësitë dhe stafin e angazhuar.

Strategjia e AU në lidhje me garantimin e cilësisë institucionale shfaqet e qartë si në hartimin por dhe zbatimin e saj me procedura që janë transparente.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është një njësi e cila tashmë ka krijuar një traditë në AU, e përbërë nga anëtarë të cilët mbartin historikun e standardit por dhe të përmirësimit të tij në institucion.
2. NjsBC, por dhe Komisioni për Vlerësimin Insitucional, janë njësi të cilat në mënyrë pozitive kanë kontribuar për rritjen dhe përmirësimin e cilësisë akademike dhe administrative duke qenë në kontakt të vazhdueshëm me të gjitha instancat institucionale.
3. GVJ konstaton së NjsBC, përmes planeve dhe strategjive për përmirësimin e strategjisë institucionale, por dhe përmes metodologjive transparente dhe gjithpërfshirëse, garanton një proces sa me transparent dhe konstruktiv për institucionin.

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkimore

Terma reference: misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj.

Programi i studimit Bachelor në “Dizajn” ofrohet nga Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, nën përgjegjësinë e Departamentit të Arkitekturës (Vendim Senati Nr. 51/2 prot., datë 09.03.2016). Ky program, siç përcaktohet në Rregulloren të tij (Kreu II, Neni 4), ka objektiva të përgjithshme në përputhje me misionin dhe qëllimet e institucionit dhe strategjinë për zhvillim të institucionit si dhe hartimi i tij është në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe me zhvillimin e vendit, pa rënë ndesh me interesat dhe vlerat kulturore kombëtare.

Programi i studimit synon pajisjen me njohuri bazë dhe mbi metoda e parime krijuese-shkencore të përgjithshme mbi çështje të dizajnit.

Objektiva specifike të ekspozuara në rregulloren e programit të studimit janë si më poshtë:

1. Gjatë vitit të parë akademik, programi Bachelor në “Dizajn” ka si synim t’u ofrojë studentëve njohuri të përgjithshme dhe specifike të programit, mbështetur në lëndë të formimit bazë, plotësues dhe ndërdisiplinor.
2. Gjatë dy viteve të tjera akademike, studenti thëllon njohuritë që përkojnë me profilin e diplomës Bachelor në “Dizajn”.
3. Ofrimin studentëve të njohurive të cilat lejojnë ndjekjen e cikleve pasardhëse të studimit apo vijimin e karrierës profesionale.

Shqyrtimi i kurrikulës, në sintoni me ciklin e parë të studimeve, shpreh qartë që synimi i programit është t’u japë studentëve një formim me spektër të gjerë në fushën e dizajnit. Ky objektivi duket dhe në përputhje me shpërndarjen e krediteve/ lëndëve ku rreth 17.2% e tyre (31 ECTS) janë lëndë

bazë (A) ndërkohë që 53.9 % të tyre (97 ECTS) janë në lëndë karakterizuese (B) të fushës së studimit.

Kështu, thellimi i formimit të marrë në këtë cikël të parë studimesh mund të vijohet më tej në fusha specifike të dizajnit si në angazhimet profesionale edhe gjatë ciklit të dytë të studimeve. Vetë AU ofron këtë mundësi të thellimit të studimeve në Masterin Profesional në Dizajn Interieri, duke qenë kështu në përputhje me vizionin dhe misionin e institucionit.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Programi i ciklit të parë të studimit, Bachelor në "Dizajn" është hapur me Urdhër Nr. 199, datë 16.05.2012 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, në përputhje me VKA Nr. 319, datë 16.03.2012. Ky program studimi është akredituar me kusht me Urdhër Nr. 439, datë 25.08.2016 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, bazuar në Vendimin Nr. 177, datë 07.07.2016 të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë. Akreditimi i parë i programit është realizuar me Vendimin Nr. 74, datë 21.09.2017 të Bordit të Akreditimit, me kohëzgjatje vlefshmërie deri më 30/09/2019.

Siç shprehet edhe në RVB, programi i studimit Bachelor në "Dizajn" ka për qëllim krijimin e një profili të diplomuar me njohuri bashkëkohore, i aftësuar për të zhvilluar një sërë shprehish dhe kompetencash për:

- aktivizimin në institucione, studio apo kompani të ndryshme në fushën e dizajnit;
- aktivizimin në industrinë e prodhimit dhe realizimit të punimeve në fushën e dizajnit;
- ndjekjen e niveleve të tjera të studimi Master në fushën e dizajnit apo fusha të ngjashme.


Nga raportet dhe takimet me njësitë drejtuese, stafin dhe studentët, evidentohet fakti që BSc në Dizajn ka si qëllim ofrimin e një formimi të gjerë por dhe me kompetenca specifike nëpërmjet kombinimit të njohurive teorike dhe praktike në fushën e dizajnit. Lëndët dhe modulet e programit mbulojnë mjaft gjerë "fushat/spektrin" e dizajnit duke u mundësuar dhe hapur rrugën studentëve për profilizim të mëtejshëm, si në nivel akademik dhe profesional.

Siç është ekspozuar edhe në RVB, gjykojmë që formimi i marrë nga ky program, aftëson studentët për punësim në nivele të ndryshme dhe punë të ndryshme, si:

- Studio dizajni grafik;
- Studio projektim interieri;
- Studio fotografike;
- Galeri arti;
- Studio televizive;
- Shtypshkronja dhe shtëpi botuese;
- Individualisht në sektor privat etj.

Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

Programi i studimit Bachelor në Dizajn, është një program studimi me kohë të plotë dhe me një kohëzgjatje prej 3 vitesh akademike, me një total prej 180 ECTS. Çdo vit akademik është i ndarë në dy semestra, ndërkohe sasia e javëve për çdo vit akademik apo semestër është si më poshtë:

 1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor

- 1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor
- 1 ECTS 25 orë mësimore punë të studentit
- 1 orë mësimore 50'

- Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë (*Tabela 10 e Anekseve*)

Programi i studimit Bachelor në Dizajn në vitin akademik 2017-2018 zhvilloi 21 lëndë/module (përfshirë 2 lëndët me zgjedhje, “Grafikë” dhe “Art 2D”, si dhe praktikën profesionale) dhe punimin e diplomës.

Programi i studimit Bachelor në Dizajn në vitin akademik 2018-2019 zhvilloi 24 lëndë/module (përfshirë 2 lëndët me zgjedhje, “Grafikë” dhe “Art 2D”, lëndë këto të fundit të detyrueshme për vitin e parë që nis në vitin akademik 2018-2019, si dhe praktikën profesionale) dhe punimin e diplomës. Duke qenë një vit tranzitor me kurrikulën e ndryshuar (shiko më tej te seksioni “Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara”), viti i parë zhvillon lëndët konform programit të ri, ndërkohë lëndët e ofruara për vitin e dytë dhe të tretë janë në sintoni me kurrikulën e mëparshme me qëllim përmbushjen e të gjitha lëndëve për vitet e regjistruara më parë.

Programi i studimit Bachelor në Dizajn (për studentët që nisin vitin e parë në vitin akademik 2018-2019) përmban 22 lëndë të organizuara në 28 module (përfshirë 2 lëndët me zgjedhje, praktikën profesionale dhe punimin e diplomës) me një kohëzgjatje prej 3 (tre) vitesh akademike. Ky program studimi me kohë të plotë, ofrohet nga Departamenti i Arkitekturës pranë Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike.

Studentët përmbushin kërkesat për titullin Bachelor në Dizajn nëse plotësojnë 180 kredite sipas sistemit ECTS (Sistemit European të Transferimit të Krediteve) ku një krediti të formimit i korrespondojnë 25 orë mësimore punë të studentit, të ndara sipas rastit në orë mësimore për transmetim dijesh në auditor (leksione, seminare, detyra, praktika, etj.) dhe orë mësimore për përgatitje ose punë individuale të tij.

Për hartimin e planeve dhe programeve mësimore janë marrë parasysh raportet ndërmjet tipeve të ndryshme të komponentëve mësimorë. Kështu, rreth 17.2% e tyre (31 ECTS) janë lëndë bazë (A) ndërkohë që 53.9 % të tyre (97 ECTS) janë lëndë karakterizuese (B) të fushës së studimit. Pjesa e mbetur është ndarë 13.9% (25 ECTS) lëndë ndërdisiplinore/ integruese (C), 10.6% (19 ECTS) në lëndë plotësuese (D) dhe 4.4 % (8 ECTS) të dedikuara për përgatitjen e detyrës së diplomës (E), ku përqindja totale e lëndëve të kategorive A dhe B është 71.1 %. (*Tabela 12 e Anekseve*)

GVJ gjykon që kurrikula është organizuar në përputhje me objektivat e programit dhe formimin që synon t’i japë studentit duke ruajtur njëherazi një raport të ekuilibruar të tipeve të veprimtarive brenda planit mësimor të programit të studimit.

- Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:
- Për leksionet 10 orë në auditor dhe 15 orë punë e pavarur e studentit
 - Për Seminaret 7.5 orë në auditor dhe 17.5 orë punë e pavarur e studentit
 - Për Detyrë/Projekt 2 orë në auditor dhe 23 orë punë e pavarur e studentit
 - Për Praktikën lëndore 22.5 orë në auditor dhe 2.5 orë punë e pavarur e studentit
 - Për Praktikën Profesionale 22.5 orë në auditor dhe J/A orë punë e pavarur e studentit
 - Provimi përfundimtar (Diplome) 2 orë në auditor dhe 23 orë punë e pavarur e studentit

Sasia mesatare e punës së kryer gjatë një viti studimesh nga një student në këtë program studimi me kohë të plotë, është 60 ECTS, ekuivalent me 1500 orë mësimore pune të studentit, të cilat përfshijnë orë në auditor dhe orë pune të pavarur të tij.

Orët për punë të pavarur të studentit zënë jo më pak se gjysmën e fondit të përgjithshëm të 1500 orëve mësimore vjetore (konkretisht raporti orë në auditor/punë e pavarur është 653/847 për vitin I, 717/783 për vitin II dhe 708/792 për vitin III).

GVJ e gjykon këtë ndarje si të përshtatshme me nivelin dhe natyrën e programit të studimit si dhe në përputhje me udhëzimet për këtë qëllim.

Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara (*Tabela 11 e Aneksëve*)

Në bazë të dokumentave të vëna në dispozicion në DVV, plani mësimor i programit të studimit është rishikuar deri në masën jo më shumë se 20% (17.7 %) dhe është miratuar me Vendim Senati Akademik Nr. 15, date 25.04.2018, Nr. 165 Prot.. Ky plan mësimor i rishikuar, në përputhje me pikën 9, të nenit 35 të ligjit 80/2015 (si dhe VKM Nr. 41 dt. 24.01.2018, pika c), pika 2.9 profili i programit), ka marrë dhe miratimin perfundimtar të MASR me shkresë Nr. 4932/ I Prot., datë 05.06.2018 dhe filloi zbatimin për herë të parë në vitin akademik 2018-2019. (I gjithë procesi i ndryshimit të kurrikulës, që nga propozimi i Departamentit në mbledhjen e datës 01.02.2018 e deri te kthimi i përgjigjës nga MASR për miratimin e ndryshimeve me shkresë Nr. 4932/ I Prot., datë 05.06.2018, është dokumentuar në “aneksin” “1.4 Procedura e ndryshimit të kurrikules për programin e studimit Bachelor në Dizajn” të dorëzuar në DVV).

Studentët e regjistruar përpara vitit akademik 2018-2019 vijojnë me planin mësimor të vjetër.

Më konkretisht, ndryshimet e bëra janë të përshkruara si më poshtë:

1. “Komunikim Vizual” (9 ECTS, lëndë semestrale në semestrin e parë të vitit të parë) kthehet në lëndë të “ponderuar” e përbërë nga moduli/lënda “Komunikimi Vizual 1” (6 ECTS, në semestrin e parë të vitit të dytë) dhe moduli/lënda “Komunikim Vizual 2 (5 ECTS, në semestrin e dytë të vitit të dytë).
2. Lëndës “Kaligrafi”, lëndë semestrale me 9 ECTS në semestrin e parë të vitit të parë, i ulet pesha me 1 ECTS duke u bërë kështu prej 8 ECTS.
3. “Histori Arti I” (9 ECTS), lëndë semestrale në semestrin e parë të vitit të parë, kthehet në lëndë të “ponderuar” (10 ECTS) e përbërë nga moduli/lënda “Histori Arti I /1” (5 ECTS, në semestrin e parë të vitit të parë) dhe moduli/lënda “Histori Arti I /2 (5 ECTS, në semestrin e dytë të vitit të parë).
4. “Ilustrim” (9 ECTS), lëndë semestrale në semestrin e dytë të vitit të parë, kthehet në lëndë të “ponderuar” (11 ECTS) e përbërë nga moduli/lënda “Ilustrim 1” (6 ECTS, në semestrin e parë të vitit të dytë) dhe moduli/lënda “Ilustrim 2 (5 ECTS, në semestrin e dytë të vitit të dytë).
5. “Arti dhe Gjuha Shqipe”, lëndë semestrale me 9 ECTS në semestrin e dytë të vitit të parë ndryshohet në “Gjuhë Shqipe dhe Shkrim Akademik” (5 ECTS) në semestrin e parë të vitit të parë.
6. “Fotografi” lëndë semestrale me 9 ECTS në semestrin e parë të vitit të dytë kalon me një peshë më të vogël (8 ECTS) në semestrin e parë të vitit të tretë. Njëherazi së bashku me

lëndën/modulin “Multimedia” (8 ECTS në semestrin e dytë të vitit të tretë) “ponderohen” në lëndën “Fotografi dhe Multimedia” (16 ECTS).

7. Lëndës “Njohje Projekti”, lëndë semestrare me 9 ECTS në semestrin e parë të vitit të dytë, i ulet pesha më 1 ECTS duke u bërë kështu prej 8 ECTS.
8. “Interier Dizajn” lëndë semestrare me 9 ECTS në semestrin e parë të vitit të dytë ndryshohet në 8 ECTS dhe kalon në semestrin e dytë të vitit të dytë.
9. “Gjuhë Angleze” (8 ECTS, lëndë vjetore në vitin e dytë) kthehet në lëndë të “ponderuar” (po 8 ECTS) e përbërë nga moduli/lënda “Gjuhë Angleze 1” (4 ECTS, në semestrin e parë të vitit të parë) dhe moduli/lënda “Gjuhë Angleze 2 (5 ECTS, në semestrin e dytë të vitit të parë).
10. “Arti Grafik i Botimeve”, lëndë semestrare me 9 ECTS në semestrin e dytë të vitit të dytë ndryshohet në 8 ECTS dhe kalon në semestrin e parë të vitit të tretë.
11. “ Histori Arti II” lëndë semestrare me 9 ECTS në semestrin e dytë të vitit të dytë ndryshohet në 5 ECTS dhe kalon në semestrin e parë të vitit të dytë.
12. “ Multimedia”, lëndë semestrare me 8 ECTS në semestrin e parë të vitit të tretë kalon me të njëjtin peshë dhe program në semestrin e dytë të vitit të tretë.
13. “Vizatim Bashkëkohor”, lëndë semestrare me 8 ECTS në semestrin e parë të vitit të tretë kalon me të njëjtin peshë dhe program në semestrin e dytë të vitit të parë. Njëherazi së bashku me lëndën/modulin “Vizatim i detajuar” (8 ECTS në semestrin e parë të vitit të parë) “ponderohen” në lëndën “Vizatim” (16 ECTS).
14. “Pikturë Monumentale”, lëndë semestrare me 8 ECTS në semestrin e parë të vitit të tretë ndryshohet në 7 ECTS dhe kalon në semestrin e dytë të vitit të dytë.
15. “Menaxhim Arti” lëndë semestrare me 8 ECTS në semestrin e dytë të vitit të tretë ndryshohet në 6 ECTS dhe kalon në semestrin e parë të vitit të tretë.
16. Lëndës me zgjedhje “Bazat e Pikturës”, lëndë semestrare me 7 ECTS në semestrin e dytë të vitit të dytë i ulet pesha më 2 ECTS duke u bërë kështu prej 5 ECTS.
17. “Art 2D” (7 ECTS, lëndë semestrare me zgjedhje në semestrin e dytë të vitit të dytë) rikonceptohet si 2 “lëndë” me detyrim, përkatësisht “Art 2D/1” (6 ECTS, në semestrin e dytë të vitit të parë) dhe “Art 2D/ 2 (6 ECTS, në semestrin e parë të vitit të dytë).
18. Punimi i Diplomës nga 6 ECTS bëhet 8 ECTS.

Përtej procesit të përmirësimit dhe ndryshimeve normale që mund të kenë programet e secilës lëndë (syllabuset), duke lënë mënjandë dhe faktin e spostimit të disa lëndëve në semestra/vite të ndryshme, në bazë të ndryshimeve të deklaruara rezulton që 31 ECTS ka qënë ndryshimi në program (shtuar apo hequr në lëndë të ndryshme) çka përbën rreth 17% të peshës së programit të studimit. GJVJ gjykon që këto ndryshime janë në funksion të përmirësimit të programit duke dhënë në mënyrë më koherente dijet e nevojshme sipas një rendi logjik/kohor më të ekuilibruar si dhe njëherazi vërehet një rritje e peshës së lëndëve karakterizuese dhe e detyrimeve përmbyllëse ku së bashku me rritjen dhe të peshave të praktikave brenda lëndëve të veçanta ndikon në një aftësim më të profilizuar e specifik të studentëve. Së fundmi, diçka e tillë është konfirmuar dhe nga takimi me stafin si dhe nga vetë studentët.

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës (Tabela 13 e Anekseve)

Nga shqyrtimi i planeve mësimore rezulton se stafi i angazhuar në programin Bachelor në Dizajn për vitin akademik 2017-2018 përbëhet nga 11 pedagogë Personel Akademik Efektiv dhe 8 pedagogë Personel Akademik me Kontratë, ku 73% e orëve në auditor mbulohen nga personeli

akademik efektiv. Nga shqyrtimi i planeve mësimore rezulton se stafi i angazhuar në programin Bachelor në Dizajn për vitin akademik 2018-2019 përbëhet nga 8 pedagogë Personel Akademik Efektiv dhe 6 pedagogë Personel Akademik me Kontratë, ku 74% e orëve në auditor mbulohen nga personeli akademik efektiv.

Nga stafi i angazhuar në programin e studimit në vitin akademik 2018-2019, 1 është me titull Prof. Dr., 8 me gradën shkencore Docent-Doktor, 8 me gradën shkencore Doktor dhe 5 asistentë me MSc. Nga 24 module që zhvillohen pa diplomën, 12 mbulohen nga personel akademik efektiv, 4 në bashkëpunim PAE dhe PAK dhe 8 mbulohen nga personel akademik me kontratë. Ajo që bie në sy është që i gjithë Personelit Akademik Efektiv i angazhuar në këtë program studimi janë edhe staf i njësisë bazë përgjegjëse për programin. Përsa i përket stafit, gjykohet që ka një përputhje midis kapacitetit/eksperiencës/ekspertizës dhe lëndëve që mbulojnë.

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

Syllabuset e dorëzuara si pjesë e DVV janë të gjitha të unifikuara në një standard/ format (bazuar në “Shtojca Nr. 2” të Vendimit Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”) dhe në brendi të tyre përmbajnë të gjithë elementët e mëposhtëm:

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Emri dhe kontakti i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit (tipologjia e lëndës)
- Kodi i lëndës
- Përmbledhje dhe rezultatet e të nxënit (Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë)
- Konceptet themelore
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format kontrollit të dijes dhe detyrimet e studentit për lëndën (Frekuentimi dhe kontrolli I vazhdueshëm)
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

GVJ gjykon që syllabuset përmbajnë elementet e nevojshme sipas standardeve dhe aplikimi i tyre është vërtetuar dhe nga takimi me studentët si dhe nga një “cross check” i bërë në format e vlerësimit të verifikuara në Sekretarinë Mësimore.

Analizë e cilësisë së syllabuseve

Nga takimet në institucion rezulton që, pa cënuar lirinë akademike të stafit, syllabuset janë subjekt kontrolli të përvitshëm nga ana e departamentit përgjegjës për programin. Nga takimi me stafin, është konfirmuar se syllabuset hartohen nga titullarët e lëndëve dhe më pas miratohen në departamentin e fakultetit përgjegjës. Studentët gjithashtu janë shprehur se syllabuset janë të qarta dhe njihen me to që në fillim të lëndës si dhe konfirmuan respektimin e tyre gjatë semestrit.

Syllabuset janë konform standardeve të kërkuara dhe pjesa më e madhe e tyre reflektojnë pritshmëritë dhe përmbajtjen e pritshme të lëndës. Gjithsesi, GVJ, fton Departamentin dhe të gjithë aktorët e tjerë të vijojnë me pasurimin e mëtejshëm të tyre si dhe në përkujdesjen që përmbajtja e lëndëve të jetë në sintoni me nevojat efektive të studentëve të profilit, kapacitetet e tyre përthithëse

duke u bazuar në formimin paraprak të tyre si dhe në sigurimin e mos pasjes së përsëritjeve të temave specifike ndërmjet lëndëve të ndryshme. Gjithashtu, gjykojmë që pasurimi i literaturës mund të kontribuonte në një rritje të mëtejshme të cilësisë.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

I gjithë materiali i vënë në dispozicion me anë të DVV është i verifikueshëm dhe i aksesueshëm nga ana e GVJ në institucion. Materiali i dorëzuar është konform fakteve të verifikuar në institucion.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
I - PROGRAMET E STUDIMEVE TË OFRUARA	
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Programi i ciklit të parë të studimit, Bachelor në “Dizajn” është hapur me Urdhër Nr. 199, datë 16.05.2012 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, në përputhje me VKA Nr. 319, datë 16.03.2012 në Universitetin “Albanian University”. Aktualisht, programi ka një akreditim me vlefshmeri 2-vjeçare deri më 30/09/2019, me Vendimin Nr. 74, datë 21.09.2017 të Bordit të Akreditimit.</p> <p>Programi është i organizuar në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> <p>Programi i studimit Bachelor në Dizajn (për studentët që nisin vitin e parë në vitin akademik 2018-2019) përmban 22 lëndë të organizuara në 28 module (përfshirë 2 lëndët me zgjedhje, praktikën profesionale dhe punimin e diplomës). Ky program studimi me kohë të plotë, ofrohet nga Departamenti i Arkitekturës pranë Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike dhe ka një kohëzgjatje prej 3 vitesh akademike me një total prej 180 ECTS. Çdo vit akademik, i ndarë në dy semestra, ka 60 kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.4 - Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara dhe informuese.	
<p>Kriteri 1 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për përmbajtjen e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për lëndët me zgjedhje apo të detyruara për semestër;</p>	<p>Ky program studimi me kohë të plotë, ofrohet nga Departamenti i Arkitekturës pranë Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike. Nga materialet e vëna në dispozicion dhe nga verifikimet e bëra, njësitë përgjegjëse për programin e studimit, hartojnë në fillim të çdo viti akademik planin mësimor të programit të</p>

Kriteri 3 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ ndjekjen e programit;

Kriteri 4 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikat, ushtrimet apo orët e laboratorit, etj.

studimit që përmban të gjitha informacionet e nevojshme për përmbajtjen e programeve të studimeve.

Këto informacione përfshijnë lëndët/modulet e programit me ndarjet sipas tipeve të veprimtarive, kreditet përkatëse sipas ECTS, tipologjinë e tyre të detyruara apo me përzgjedhje, pedagogët përkatës, etj. Gjithashtu informacioni ka të qartë ngarkesën mësimore, orët në auditore, praktikat mësimore, format e mësimdhënies, shpërndarjen e peshës së tyre, etj.

Informacione mbi programet e studimeve (info të përgjithshme dhe lëndët që përmban kurrikula gjenden dhe janë publike në manifestin akademik, në ambjentet e universitetit si dhe në faqen ëeb të universitetit: <https://albanianuniversity.edu.al/sq/fakulteti-i-shkencave-te-aplikuara-dhe-ekonomike-2/>

Programi i studimit ka gjithashtu një rregullore të plotë ku prezantohen struktura organizative, objektivat e përgjithshme, objektivat specifike të programit, programi mësimor dhe struktura e tij (lëndët, sasia e krediteve, orët e mësimimit, disiplinat mësimore dhe peshat e tyre), format e organizimit të mësimdhënies, plani mësimor, krediti dhe llogaria e tij, kriteret dhe procedurat e pranimit, regjistrimi, kohëzgjatja e studimeve, transferimet, organizimi i procesit mësimor, frekuentimi, sesioni, organizimi dhe rregullat e provimeve, kontrolli ose vlerësimi i dijes, të drejta dhe detyrime të studentit, praktikat profesionale, diplomimi, sigurimin e cilësisë, etj. Secila prej lëndëve/moduleve ka syllabusin përkatës ku mund të gjenden emërtimi i lëndës/modulit, emri dhe kontakti i pedagogut që do të zhvillojë lëndën, ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS, viti/semestri kur zhvillohet lënda, vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit (tipologjia e lëndës), kodi i lëndës, përmbledhje dhe rezultatet e të nxëniet (Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë), konceptet themelore, temat që do të trajtojnë lënda në formimin teorik dhe praktik, format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre, format kontrollit të dijes dhe detyrimet e studentit për lëndën (frekuentimi dhe kontrolli i vazhdueshëm) dhe literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse.

Ndërkohë si nga takimi me instancat drejtuese/koordinuese ashtu dhe me Zyrën e Koordinimit dhe Mbështetjes së Studentëve dhe vetë studentët është

konfirmuar që çdo fillim viti organizohen aktivitete orientuese (18 Tetor i fundit bazuar në Aneksin 9.2 të DVV) ku studentet informohen mbi rregulloren, programin, kalendarin, lëndët (të detyruara dhe me zgjedhje), pedagoget, oraret, ambientet e mësimdhënies, të dretjat dhe detyrimet, etj.

Në fillim të çdo lëndë gjithashtu, pedagogët përkatës bëjnë një prezantim të saj me të gjitha informacionet mbi syllabusin dhe përmbajtjen, karakteristikat dhe organizimin e lëndës.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Programi i ciklit të parë të studimit, Bachelor në "Dizajn" është në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit.
2. Programi është me kohë të plotë dhe me një kohëzgjatje prej 3 vitesh akademike me një total prej 180 ECTS, i organizuar në module të vlerësuara në kredite sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Çdo vit akademik është i ndarë në dy semestra dhe ka në total 60 kredite ECTS.
3. Kurrikula e Bachelor në Dizajn është organizuar në përputhje me objektivat e programit dhe formimin që synon t'i japë studentit duke ruajtur njëherazi një raport të ekuilibruar të tipeve të veprimtarive brenda planit mësimor të programit të studimit.
4. Njësitë përgjegjëse për programin e studimit sigurojnë çdo vit zhvillimin dhe shpërndarjen e të gjitha materialeve dhe informacioneve të nevojshme për përmbajtjen e programeve të studimeve.
5. Rregulloret e programeve të studimeve japin një pasqyrë të plotë të objektivave, ciklin e studimit, kohëzgjatjen, kreditet, kriteret e pranimit, transferimet, planeve mësimore, të drejtat dhe detyrimet, etj.
6. Planet mësimore përmbajnë informacionet e nevojshme mbi sasinë e lëndëve/moduleve, tipet e veprimtarive, kreditet përkatëse sipas ECTS, stafin, ngarkesën mësimore, orët në auditore, praktikat profesionale, format e mësimdhënies, shpërndarjen e peshës së tyre, etj.
7. Syllabuset janë të gjitha të unifikuara në një standard/ format dhe përmbajnë një informacion të plotë në lidhje me lëndën bazuar në kuadrin ligjor dhe udhëzimet në fuqi. Çdo pedagog në fillim të lëndës/modulit u prezanton studentëve përmbajtjen e plotë të saj si dhe materialet plotësuese.
8. Materiali dhe informacioni në lidhje me programet është i plotë si dhe i aksesueshëm sipas nevojës në mënyra të shumëfishta si faqja ëeb, Departament, Sekretarinë Mësimore, Zyrën e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët, të ekspozuara në ambientet e institucionit, etj.

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësishë etj.

Procesi i mësimdhënies është i përcaktuar/rregulluar dhe në Rregulloren e Programit të studimit Bachelor në “Dizajn”, më konkretisht te Kreu IV – “Organizimi i procesit mesimor dhe kontrolli i dijeve”, ku jepen të dhëna mbi organizimin e grupeve mësimore, frekuentimin, kohëzgjatjen e seancave mësimore, provimet, kontrolli dhe vlerësimi i dijes, etj.

Bazuar në dokumentat e DVV dhe nga informacionet e marra gjatë takimit me njësitë drejtuese, stafin akademik, studentët, njësia e sigurimit të cilësisë, etj., u konstatua që mësimdhënia është një proces i cili monitorohet dhe vlerësohet vazhdimisht duke marrë parasysh opinionet e të gjithë të palëve në këtë proces.

Vetë syllabuset e lëndëve, përvec përmbajtjes dhe aspekteve formale të ndarjes në ECTS, orë, etj., kanë informacione mbi metodologjinë dhe anën didaktike.

Nga takimi me njësitë e ndryshme dhe me stafin akademik, u vu në dukje fakti që stafi akademik ka lirinë e tij akademike në përzgjedhjen e përmbajtjes dhe metodave më të përshtatshme për të zhvilluar lëndën, por që vazhdimisht janë subjekt sugjerimesh e rishikimesh nëse evidentohet nevoja, qoftë nga vetë pedagogët apo dhe nga kërkesa që mund të vijnë nga studentët (kërkesa të drejtpërdrejta apo bazuar në formularët e vlerësimit të NjSBC) apo nga Njësitë Bazë (verifikuar një rast nga Aneksi 6.5 i DVV ku gjendet shkresa nga NjSBC me Nr. 103 Prot., datë 07/02/2019, me lëndë “*Njoftim për realizimin e fokus-grupeve dhe të dhenave të mbledhurar*”).

Në aspektin e organizimit të grupeve mësimore, bazuar në Nenin 14 të Rregullores së Programit, puna mësimore organizohet në bazë grupi dhe kursi. Leksionet zhvillohen në bazë kursi, kurse seminarit, detyrat/projektet dhe praktiket zhvillohen në bazë grupi.

Frekuentimi i lëndëve është me detyrim deri në masën 75% të tyre, pra nëse një student kryen më shumë se 25% mungesa në seancat mësimore (leksione/seminare/detyra/praktika lëndore) të asaj lënde, nuk pranohet në sesionin e parë të provimit (nëse ka kryer deri në 50 % mungesa, atëherë ai pranohet në sesionin e dytë të provimit, ndërkohë nëse ka kryer mbi 50 % mungesa shpallet përsëritës). Ndërkohë, frekuentimi i praktikave profesionale është me detyrim në masën 100 %, përveç rasteve ku ka një justifikim të arsyeshëm për mungesa deri në jo me shume së 25 % të seancave dhe në këto raste planifikohen deri në dy seanca plotësuese për çdo semestër dhe lëndë.

Kontrolli i njohurive të studentëve përcaktohet në Rregulloren mësimore të programit të studimit ku në vija orientuese 60% e peshës i jepet provimit/dorëzimit përfundimtar, 20% provimit të ndërmjetëm dhe 20% ndjekjes së lëndës dhe pjesëmarrjes aktive, por që në varësi të lëndës mund të ketë më shumë elementë të vlerësimit të dijeve apo pesha të varjueshme të cilat përcaktohen në syllabuset e lëndëve përkatëse.

Metodat e mësimdhënies janë një ndërthurje e metodës klasike të shpjgimit në tabelë, me projektme të materialeve mësimore të përgatitura nga pedagogët e lëndëve si dhe ekzekutimi praktik në laboratore i pjesës teorike.

Përveç formave klasike të mësimdhënies, pra të shpjgimit në tabelë, seminareve dhe detyrave, për shkak dhe të natyrës së programit janë me një peshë të madhe dhe forma të praktikës mësimore. Gjithashtu, nga takimet, verifikimet në ambjentet e shkollës, dokumentacionet e përcjella dhe shqyrtimi i syllabuseve rezulton se të pranishme në metodat e mësimdhënies janë dhe:

- Puna në grup
- Prezantime / ekspozita publike.
- Leksione të Hapura
- Vizitat studimore

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet (*Tabela 14 e Anekseve*)

- Leksione
- Seminare
- Detyra/Projekte
- Praktikë lëndore
- Praktikë profesionale

Përtej anës teorike, pra “leksioneve”, lëndet/modulet duke parë dhe karakterin specifik të këtij programi studimi, kanë shpesh në përmbajtjen e tyre edhe forma të tjera të mësimdhënies, veçanërisht komponentin e praktikës si një element themelor në përvetësimin e dijeve në “dizajn”. Me raporte të ndryshme në varësi të lëndëve/moduleve specifike, mësimdhënia zhvillohet përmes një sërë formash mësimdhënieje ku përfshihen orë leksioni, seminaresh, orë të detyrave/projekteve, praktikave mësimore (shpesh në laboratorët e vëna në dispozicion për këtë program) si dhe praktikave profesionale.

Nga analizimi i planeve mesimore dhe i të dhënave të ngarkesës totale në auditor sipas formave të mësimdhënies të programit të studimit Bachelor në Dizajn, rezulton që leksionet zënë rreth 34% (705 orë). Ndërkohë seminarët zënë rreth 5.4% (113 orë) kurse angazhimi në auditor për detyra/projekte zë rreth 4.1% të ngarkesës, e plotësuar me një 6.5% si praktikë profesionale (135 orë). Ndërkohë ajo që bie në sy është raporti i lartë që zë praktika lëndore me rreth 50 % të orëve në auditor (140 orë).

Në takimin me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave u evidentua fakti që kërkohet të stimulohet dhe trajnohet stafi për integrimin e metodave inovative të mësimdhënies ku përmendet dhe një aktivitet në kuadër të një bashkëpunimi me Universitetin e Salernos ku një profesor i huaj bëri një trajnim për mësimdhënien dhe teknologjinë. Vetë stafi akademik gjatë takimit me to ka evidentuar rëndësinë e integrimin të këtyre metodave.

GVJ e gjykon tejet pozitive dhe të rëndësishme kërkimin dhe integrimin e metodologjive të ndryshme dhe alternative të mësimdhënies, dhe sugjeron nxitjen e përdorimit sa më të gjerë të tyre pasi mund të stimulojnë procesin e të nxënimit me nxitjen e pjesëmarrjes aktive të studentëve.

Format e kontrollit të njohurive (*Tabela 15 e Anekseve*)

Format e kontrollit të njohurive që aplikohen përgjithësisht janë ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive, plotësimi të testeve apo të detyrave/projekteve të ndërmjetme të kursit dhe provimi/dorëzimi përfundimtar.

Një vlerësim bazuar në kombinimin e “performancës” në frekuentim, detyra /projekte apo teste të pjesshme dhe provim/dorëzim final nga njëra anë nxit një kontroll më të gjerë të formimit të studentit dhe nga ana tjetër stimulon një angazhim më konstant të studentëve.

Vihet re në përgjithësi që peshën më të madhe e zë provimi/dorëzimi përfundimtar me peshë 60% të totalit prej 100%. Ndërkohë ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive varion nga 10%-40% të vlerësimit të përgjithshëm në varësi të tipologjisë së lëndës (duke pasur dhe karakter pengues në rast mosfrekuentimi sipas rregulloreve përkatëse). Së fundmi, testimet apo dorëzimi i detyrave/projekteve të ndërmjetme të kursit (kur ka) varion nga një peshë mesatare 10%-20% të vlerësimit të përgjithshëm.

Gjithsesi, në varësi të natyrës së lëndës, raportet dhe peshat specifike të formave të kontrollit të njohurive mund të jenë të variueshme dhe ato janë të përcaktuara qartë dhe në syllabuset e lëndëve

përkatëse (p.sh lëndët praktike mund t'i japin një peshë më të madhe pjesëmarrjes aktive dhe dorëzimeve të ndërmjetme, ndërkohë një lënde teorike më shume provimit përfundimtar).

Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj. (Tabela 18 e Aneksëve)

Bazuar në materialet e DVV, takimet me njësitë drejtuese të institucionit, me stafin akademik dhe studentët, u konstatua që ka një angazhim të studentëve në aktivitetet e organizuara nga njësitë.

Mënyrat e angazhimit janë të disa llojeve që shkojnë nga pjesëmarrjet si "publik" deri të pjesëmarrjet aktive me prezantime apo punë e aplikuar. Natyrisht, natyra dhe cikli i programit nënkupton që angazhimet nuk mund të jenë në përgjithësi me një prerje të mirëfilltë "shkencore". E thënë kjo, nga biseda me studentët u verifikuan fakte të paraqitura në raportin e vlerësimit të brendshëm në lidhje me angazhime aktive të studentëve.

GVJ konstaton pjesëmarrje me prezencë të thjeshtë në një sërë aktivitetesh apo vizitash studimore të organizuara nga Universiteti si ekspozita të ndryshme, Muzeu Kombëtar i Fotografisë "Marubi", vizita studimore "Arti i Onufrit", Workshop "Animacioni", aktiviteti Home Movie Day-Albania, etj.

Në mënyrë të veçantë janë për t'u përmendur pjesëmarrja (3 persona) në Konferencën Studentore 2017-2018 dhe 2018-2019, organizuar nga Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike apo pjesëmarrja (4 pjesëmarrës) në edicionin e IV-të dedikuar grafikës artistike shqiptare "Shenja ere shqiptare-Grafika 15".

GVJ gjykon që, dhe pse kapaciteti dhe njohuritë gjatë ciklit të parë të studimeve janë jo shumë të mëdha për t'u angazhuar në projekte apo aktivitete të mirëfillta shkencore, vërehet një aktivizim, veçanërisht i stimuluar nga një grup lëndësh/pedagogësh, në aktivitete të rëndësishme për programin e studimit dhe sugjerohet vijimësia e këtij procesi dhe stimulimi dhe i mëtejshëm ku është i mundur.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Dokumentacioni i vënë në dispozicion në DVV ishte mëse i mjaftueshëm për zhvillimin e analizave, ndërkohë gjatë vizitës në institucion janë parë, syllabuse të ndryshme, verifikimi në sekretari i proces-verbaleve të ndryshme që konfirmonin si zbatimin e planeve mësimore ashtu dhe i formave të kontrollit, frekuentimit, etj. Ndërkohë janë verifikuar dhe kryerja e aktiviteteve (te publikuara dhe të revista "optime") apo nga list prezencë në leksione të hapur (të dizajneres B.M).

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Pranimi në Programin Bachelor në Dizajn bëhet në përputhje me Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë".

Ka një procedurë të përcaktuar të pranimit të studentëve dhe afateve të studimit (KREU III i rregullores së programit) ku sqarohet së pari që kandidatët që duan të ndjekin Bachelor-in në "Dizajn", duhet të kryejnë procesin e aplikimit on-line në portalin e Maturës Shtetërore.

Bazuar në pikën 2 të Nenit 10 të Rregullores së programit, aplikimi kryhet nga kandidatët që kanë përfunduar arsimin e mesëm dhe:

- a. janë të pajisur me dokumentacionin ligjor të perfundimit të këtij niveli arsimor (pra kanë përfunduar maturën shtetërore ose Diplomën e shkollës së mesme (të përgjithshme ose të profilizuar, sistemi i vjeter) ose Diplomën e shkollës së mesme profesionale 5 vjeçare, ose Dëftesa e shkollës së mesme të fituar jashtë vendit, të vlerësuar të barasvlefshme me të në Shqipëri);
- b. nuk rezultojnë të regjistruar në një program tjetër studimi, në IAL-të publike ose jopublike;
- c. plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave (Programi i studimit Bachelor në Dizajn pranon studentë, të cilët kanë notën mesatare mbi 6);
- d. plotësojnë kriteret e përcaktuara nga AU për programin e studimit.

Studentët marrin një informim mjaft të gjerë në lidhje me programet e studimit apo informacione të tjera të nevojshme për mbarëvajtjen e studimeve të tyre. Në organikën e Universitetit ekzistojnë struktura të cilat fokusohen në një informim dhe mbështetje të studentëve si gjatë studimit, përfshirë dhe lehtësirat e gjetjes dhe kryerjes së praktikave profesionale apo ku është e mundur dhe lehtësimin e procesit të punësimit, ashtu dhe pas përfundimit të studimeve siç janë Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët dhe Zyra e Karrierës dhe Alumnit .

Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët ka për mision orientimin dhe të mbështetjen e studentëve për zhvillimin e tyre profesional dhe personal nëpërmjet informimit mbi aspekte procedurale dhe organizimi të programit të studimit por dhe të aktivizimit në programe jashtë mësimore apo në përgatitjen e tyre për punësim.

Zyra e Karrierës dhe Alumnit ka si qëllim aktivizimin e studentëve pas përfundimit të programit të studimit në veprimtari me karakter shkencor, profesional, social dhe kulturor si brenda dhe jashtë institucionit (shpesh gjatë organizimit të "Open Days").

Ndërkohë si nga takimi me instancat drejtuese/koordinuese ashtu me Zyrën e Koordinimit dhe Mbështetjes së Studentëve, Zyrën e Karrierës dhe Alumnit dhe vetë studentët është konfirmuar që çdo vit organizohen aktivitete orientuese dhe këshilluese të karrierës (18 Tetor i fundit bazuar në Aneksin 9.2 të DVV) ku studentët informohen mbi rregulloren, programin, kalendarin, lëndët (të detyruara dhe me zgjedhje), pedagogët, oraret, ambientet e mësimdhënies, të drejtat dhe detyrimet, klubet studentore, etj.

Institucioni vë në dispozicion një sërë materialesh informuese dhe udhëzuese për studentin si:

- Manifesti Akademik, brenda së cilit gjenden informacione të përgjithshme mbi kalendarin akademik, misionin e institucionit, organizimin institucional, shërbimet e ofruara, procedurat e regjistrimit, transferimit, programet, mbështetjen ndaj studentëve, etj.
- Udhëzuesi i Karrierës, ku studentët marrin informacione të rëndësishme në lidhje me ide praktike për zgjedhjen e karrierës, përgatitja e CV dhe letrave motivuese, formimin e kapaciteteve prezantuese përpara punëdhënësve potencial, etj.
- Manuali i studentit, brenda të cilit jepen informacione në lidhje me statusin e studentit, organizimin e vitit akademik, oraret mësimore, llogaritjen e krediteve, pjesëmarrja në auditor, provimet, praktikat mësimore, programet mësimore, rregulla etike, transferime, procedura disiplinore, etj.

- Rregulloren e Programit të Studimit që përfshin një informacion të plotë mbi të gjithë elementët e programit.

Të gjitha materialet dhe informacionet e duhura mbi programet e studimit janë lehtësisht të aksesueshme në faqen zyrtare në ueb-in e Universitetit.

Në fillim të çdo lëndë gjithashtu, pedagogët përkatës bëjnë një prezantim të saj me të gjitha informacionet mbi syllabusin dhe përmbajtjen, karakteristikat dhe organizimin e lëndëve përkatëse ndërkohë vetë studentët kanë të drejtën e vlerësimit të pedagogëve dhe lëndëve përkatëse me anë të pyetësorëve të zhvilluar nga NjSBC. Përsa i përket kushteve dhe ambjenteve të vëna në dispozicion të studentëve, mund të thuhet që përmbushin kushtet e nevojshme për zhvillimin e programit.

Nga takimi i bërë me studentët gjatë vizitës së GVJ në institucion është konstatuar që ka një nivel të mirë kënaqësie dhe vlerësimi nga studentët përsa i përket ambjenteve, mësimdhënies, gadishmërisë së stafit akademik dhe administrativ si dhe fasilimitit të praktikave profesionale.

Vlerësimi i Tregues të matshëm:

- Procedurat e pranimit të studentëve

Pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me Ligjin nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”. Procedurat e pranimit të studentëve janë të përcaktuara në “Rregulloren e Regjistrimeve dhe transferimeve” (Aneksi “9.1 Rregullore e regjistrimeve dhe transferimeve.pdf”i DVV) apo në nenet 10-13 të Rregullores Mësimore të Programit të Studimit Bachelor në Dizajn.

Bazuar në RVB, pranimi i kandidatëve të rinj është me dosje dhe kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve në programin e studimit Bachelor në Dizajn janë:

- Mesatarja e përgjithshme 70%
- Mesatarja e gruplëndëve 30%
- Vizatim Teknik 15%
- Informatikë 10%
- Histori Arti 5 %

Kandidati që regjistrohet ka të drejtë të ndjekë studimet në vitin akademik përkatës, nëse dorëzon brenda afateve të shpallura të gjithë dokumentacionin e nevojshëm juridik si dhe nënshkruan kontratën e regjistrimit me institucionin duke fituar kështu statusin e studentit.

GVJ ka verifikuar pranë Sekretarisë Mësimore një sërë dosjesh studentësh të regjistruar si dhe raste transferimesh (1 rast).

Dosjet e studentëve përmbajnë:

- Kontratën e studentit (për çdo vit akademik);
- Formular aplikimi;
- Deklaratë e studentit;
- Diplomë e shkollës së mesme dhe listë notash e noterizuar (nga 2016 me udhëzimin e MASR mund të mbahet edhe e noterizuar, ndërkohë studentët e huaj kishin ekuivalentimin e diplomës së shkollës së mesme nga MASR dhe dëftesa);
- Fotokopje ID;

- Foto

Dosjet e studentëve të transferuar përmbajnë:

- Lëndët që ka zhvilluar tek IAL nga është transferuar;
- Vendimin
- Fotokopje ID;
- Vërtetim çregjistrimi;
- Kontratë studenti;
- Formular aplikimi;
- Programi që ka ndjekur tek IAL nga është transferuar.

Dosjet e studentëve të çregjistruar përmbajnë:

- Kërkesa e studentit;
- Kërkesa e Kryesekretares;
- Formular aplikimi;
- Diplomë e shkollës së mesme;
- Fotokopje ID;
- Kontratë studenti.

Studenti tërheq dipomen nëse ka dorëzuar dhe merr vërtetimin e çregjistrimit.

Studenti vijon pjesëmarrjen në programin e studimit mbi kohën e rregullt të studimeve, kur shlyen detyrimet sipas planit mësimor dhe paguan tarifat përkatëse, ndërkohë që i lejohet të regjistrohet në vitin pasardhës nëse ka fituar të paktën 50% të krediteve të detyrueshme të vitit paraardhës.

Kohëzgjatja normale e studimeve në programin Bachelor në "Dizajn" është 3 vite akademike kurse afati maksimal i përfundimit të studimeve të plota është 6 vite akademike (dyfishi i afatit të rregullt), ku nuk merren në konsideratë periudhat kur studimet janë të pezulluara.

Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve (*Tabela 16 e Aneksëve*)

Mesatarja hyrëse i të regjistruarve për herë të parë në vitin e parë të vitit akademik 2017-2018 është 7.72.

Mesatarja hyrëse i të regjistruarve për herë të parë në vitin e parë të vitit akademik 2018-2019 është 7.58.

Gjatë vitit akademik 2016-2017 në programin e studimit Bachelor në Dizajn, janë të regjistruar në vitin e parë 21 studentë (21 për herë të parë). Gjatë vitit akademik 2017-2018 në programin e studimit Bachelor në Dizajn, ishin të regjistruar në vitin e parë gjithsej 22 studentë (20 të regjistruar për herë të parë, 1 i transferuar dhe 1 i ardhur nga stazhi), me kalueshmëri 99.38% dhe notë mesatare 8.25, në vitin e dytë të regjistruar gjithsej 19 studentë me kalueshmëri 98.44% dhe notë mesatare 7.94, në vitin e tretë të regjistruar gjithsej 20 studentë me kalueshmëri 96.43% dhe notë mesatare 7.93.

Cilësia në hyrje e studentëve është mesatare, ndërkohë që shihet që mesatarja në hyrje ka një trend konstant. Duke qenë se studentët e dy viteve të fundit nuk janë diplomuar dhe viti aktual akademik nuk ka përfunduar, GVJ nuk është në gjendje të shprehet saktë dhe në mënyrë të plotë mbi ecurinë e këtyre studentëve (përveç vitit të parë të regjistruar në vitin akademik 2017-2018 me mesatare

hyrëse 7.72 dhe me kalueshmëri në atë vit 99.38% dhe notë mesatare 8.25); gjithsesi duke marrë në referencë të dhënat për vitet e mëparshme të të regjistruarve vërehet në përgjithësi një kalueshmëri shumë e lartë e studentëve dhe një mesatare në dalje që mbetet në nivele të përafërta (pak më e lartë se në hyrje) me atë në hyrje çka gjykojmë që reflekton një vlerësim në sintoni me kapacitetet e studentëve në hyrje.

- Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare (Tabela 16 e Aneksëve)

Në bazë të të dhënave të marra në DVV, në vizitën në Sekretarinë Mësimore dhe regjistrat përkatëse, rezulton së numri i të regjistruarve për herë të parë në vitin e parë në tre vitet e fundit akademike është si më poshtë:

- Numri i të regjistruarve për herë të parë në vitin e parë të vitit akademik 2016-2017 është 21 studentë.
- Numri i të regjistruarve për herë të parë në vitin e parë të vitit akademik 2017-2018 është 20 studentë me mesatare hyrëse 7.72.
- Numri i të regjistruarve për herë të parë në vitin e parë të vitit akademik 2018-2019 është 33 studentë me mesatare hyrëse 7.58.

- Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse). Nota Mesatare (Tabela 17 e Aneksëve)

Nga të dhënat e dorëzuara, rezulton që në vitin e fundit (vitin akademik 2017-2018, pra të diplomuarit e regjistruar në vitin akademik 2015-2016) janë diplomuar 15 studentë.

- 0 studentë në Sezonin e Mbartjes
- 10 studentë në Sezonin e Verës
- 5 studentë në Sezonin e Vjeshtës

Për vitin akademik 2018-2019 nuk është diplomuar asnjë student.

- Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

Procedurat e pranimit të studentëve janë të përcaktuara në “Rregulloren e Regjistrimeve dhe transferimeve” (Aneksi “9.1 Rregullore e regjistrimeve dhe transferimeve.pdf”i DVV) apo në nenet 10-13 të Rregullores Mësimore të Programit të Studimit Bachelor në Dizajn. Nga sa më sipër dhe nga verifikimet e bëra, Albanian University mundëson transferimin e studentëve në programin Bachelor në Dizajn nga programeve të njëjta ose të ngjashme studimi, si brenda të njëjtit institucion apo institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë, private ose publike, vendase ose të huaj si dhe lejon transferimin e studentëve të saj në institucione të tjera të arsimit të lartë. Nga të dhënat e dorëzuara nga sekretaria mësimore, rezulton që për brezat 2016-2017 deri në 2018-2019 ka pasur një të transferuar (në vitin e parë në vitin akademik 2017-2018) si dhe dy të çregjistruar (të dy në 2016-2017, një në Vitin I dhe një në Vitin II).

- Të dhëna për punësimin e studentëve

Studentët informohen mbi mundësitë e punësimit përmes Zyrës së Karrierës dhe Alumnit (ZKA), e cila është dhe njësi përgjegjëse për komunikimin dhe kontaktin me Alumnit e Universitetit. Nga të dhënat e raportuara në DVV dhe nga takimi me ZKA për të diplomuarit në vitin 2017-2018,

raportohet se 2/3 (rreth 66.7%) e studentëve të diplomuar janë të punësuar. Ky informacion është mbledhur përmes kontakteve telefonike, me e-mail dhe kontakteve të drejtperdrejta me të diplomuarit.

Numri total i të diplomuarve (Tabela 17 e Aneksëve)

Nga të dhënat e dorëzuara, rezulton se në vitin 2017-2018 janë diplomuar gjithsej 15 studentë. Për vitin akademik 2018-2019 deri në momentin e kryerjes së vizitës në institucion nga GVJ nuk është diplomuar asnjë student.

Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)

Nga të dhënat e raportuara në DVV dhe nga takimi me Zyrës së Karrieres dhe Alumnit (ZKA), rezulton së numri total i të punësuarve në përputhje me diplomën është 5 nga 15 (rreth 33.3%) të diplomuar në vitin 2017-2018. Bazuar në informacionet e dhëna në takimin e GVJ me ZKA, pjesa më e madhe e tyre janë punësuar në kompanitë që kanë zhvilluar praktikat profesionale.

Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)

Nga të dhënat e raportuara në DVV dhe nga takimi me Zyrës së Karrieres dhe Alumnit (ZKA), rezulton së numri total i të punësuarve në jo përputhje me diplomën është 5 nga 15 (rreth 33.3%) të diplomuar në vitin 2017-2018.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Gjatë vizitës në institucion janë verifikuar të dhënat e DVV si dhe janë parë dosje studentësh të regjistruar, dosje studentësh të transferuar, dosje studentësh të çregjistruar, regjistri themeltar, regjistri i notave, procesverbale dhe verifikimi i përputhshmërisë së tyre me notat në regjistrë, regjistri mësimor, vizionim i sekretarisë online, si dhe janë marrë statistikave të regjistrimit/transferimit të studentëve për 3 vitet e fundit, rregullore e sekretarisë, listë prezencë në aktivitete, marrëveshjet e bashkëpunimit.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
IV - INSTITUCIONI MBRON TË DREJTAT E STUDENTËVE	
Standardi IV.1 - Institucioni ndjek një politikë të mirëpritjes së studentëve të rinj.	
<p>Kriteri 1 Pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni i Arsimit të Lartë propozon kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilët kanë mbaruar Maturën Shtetërore, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me Ligjin nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë".</p> <p>Procedurat e pranimi të studentëve janë të përcaktuara në "Rregulloren e Regjistrimeve dhe transferimeve" (Aneksi "9.1 Rregullore e regjistrimeve dhe transferimeve.pdf" i DVV) apo në nenet 10-13 të Rregullores Mësimore të Programit të Studimit Bachelor në Dizajn.</p>

Bazuar në RVB, pranimi i kandidatëve të rinj, brenda numrit të miratuar, është me dosje dhe kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve në programin e studimit Bachelor në Dizajn janë:

- Mesatarja e përgjithshme 70%
- Mesatarja e gruplëndëve 30%
- Vizatim Teknik 15%
- Informatikë 10%
- Histori Arti 5 %

Standardi IV.2 - Institucioni informon studentët në lidhje me politikat e punësimit.

Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve;

Kriteri 2 Studentët vlerësojnë pedagogun e çdo lënde, në përfundim të semestrit;

Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës;

Kriteri 4 Studentët informohen mbi mundësitë për punësim pas diplomimit në këtë program studimi.

Studentët marrin një informim të gjerë në lidhje me programet e studimit apo informacione të tjera të nevojshme për mbarëvajtjen e studimeve të tyre si nga njësitë bazë ashtu dhe nga Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët. Ky proces mundësohet si nga aktivitete orientuese ashtu dhe nga një gamë e gjerë materialesh si Manifesti Akademik, Manuali i studentit dhe Rregullorja e Programit të Studimit. Informacionet përfshijnë kalendarin akademik, misionin e institucionit, organizimin institucional, shërbimet e ofruara, procedurat e regjistrimit, transferimit, programet, syllabuset, detaje të kurrikulës akademike, kriterëve dhe kushteve që studentët duhet të plotësojnë, kushtet për kalimin nga një vit në tjetrin, mbështetjen ndaj studentëve, etj.

Studentët vlerësojnë pedagogun në çdo lëndë. Vlerësimi bëhet nëpërmjet plotësimit në formë anonime të një formulari të zhvilluar nga NJBSC përpara përfundimit të lëndës rezultati i së cilës bëhet pjesë integrale e vlerësimit të pedagogëve nga ana e njësisë bazë. Përveç pedagogëve, studentët mund të vlerësojnë dhe stafin administrativ apo infrastrukturen e vënë në dispozicion.

Shërbimi i këshillimit të karrierës bëhet i mundur përmes veprimtarisë së Zyrës së Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët (ZKMS) me detyrë kryesore orientimin dhe mbështetjen e studentëve për zhvillimin e tyre profesional dhe personal nëpërmjet informimit mbi programet e studimit, aktivizimit në programe jashtë mësimore, lehtësimin e gjetjes së praktikave profesionale dhe në përgatitjen/trajnimin e tyre për punësim.

Një nga detyrat e ZKMS është dhe orientimi i studentëve në treg si dhe dhënia e informacionit për mundësitë e punësimit pas diplomimit duke u vënë në dispozicion dhe një Udhëzues të Karrierës, ku studentët marrin informacione të rëndësishme në lidhje me ide praktike për zgjedhjen e karrierës, përgatitja e CV dhe letrave motivuese, formësimin e kapaciteteve prezantuese përpara punëdhënësve potencial, etj. Një mënyrë tjetër e nxitjes së punësimit është dhe pjesëmarrja në panairt e punës. Për t'u përmendur është dhe Zyra e Karrierës dhe Alumnit me qëllim aktivizimin e studentëve pas përfundimit të programit të studimit në veprimtari me karakter shkencor, profesional, social dhe kulturor si brenda dhe jashtë institucionit si dhe mbledhja e të dhënave dhe statistikave për punësimin e studentëve.

Standardi IV.3 - Institucioni disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë.

Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve, në ciklin e parë;

Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve;

Kriteri 3 Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DVV dhe verifikimi gjatë vizitës në Sekretarinë Mësimore, rezulton se çdo student ka dosjen të tij personale, ka një informacion të plotë për çdo program studimi si dhe të dhëna statistikore vjetore lidhur me regjistrimet e studentëve, transferimet, çregjistrimet e tyre, studentët e mbetur në stazh si dhe diplomimin. Një informacion i plotë ekziston dhe për vlerësimet/notat e studentëve dhe statistika përsa i përket kalueshmërisë si dhe notave mesatare në hyrje dhe dalje.

Të gjitha informacionet janë të regjistruara në regjistrat fizikë (regjistër themeltar, regjistër notash, regjistër mësimor, procesverbale, etj.) si dhe të ruajtura në format elektronik.

Standardi IV.4 Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.

Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim karriere studentëve, ndjek progresin e tyre dhe i ndihmon ata në çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor;

Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.

Përveç mbështetjes nga njësia bazë dhe sekretaria mësimore, për këshillimin e studentëve lidhur me ecurinë e procesit akademik, një rol të rëndësishëm luan Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët (ZKMS) e cila fokusohet në një informim dhe mbështetje të studentëve gjatë studimit për mbarëvajtjen e procesit mësimor por dhe njohjen paraprake me tregun e punës dhe ndërmjetësimin e lehtësimin e procesit të zhvillimit të praktikës së tyre profesionale.

Departamenti përgjegjës ka 26 marrëveshje bashkëpunimi me kompani në të cilat studentët mund të kryejnë praktikat profesionale, ku ndër të tjera konstatohet dhe mundësia e kryerjes së praktikave profesionale brenda institucionit falë shtypshkronjës „Albanian University Press“.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Pranimi në programin e studimit Bachelor në Dizajn bëhet në përputhje me Ligjin nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”.
2. Institucioni, brenda numrit të miratuar të kuotave hyrëse, ka një procedurë pranimi dhe seleksionimi të kandidatëve me dosje ku mesatarja e përgjithshme ka 70% të peshës dhe mesatarja e gruplëndeve të përcaktuara 30%.
3. Studentët kanë një informacion të gjerë mbi statusin, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve, detaje të kurrikulës akademike, kriterëve, kushteve, të drejtave, detyrimeve, etj. Informimi bëhet nëpërmjet kanaleve të shumëfishta, si aktivitetet informuese, Manifesti Akademik, Manuali i studentit, Rregulloria e Programit të Studimit, kontratat e studentit, faqja ëeb, etj.
4. Studentët vlerësojnë pedagogun në çdo lëndë nëpërmjet plotësimit në formë anonime të një formulari të zhvilluar nga NJBSC përpara përfundimit të lëndës.
5. Shërbimi i këshillimit të karrierës bëhet i mundur përmes veprimtarisë së Zyrës së Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët (ZKMS) me detyre kryesore informimin, orientimin dhe mbështetjen e studentëve për zhvillimin e tyre profesional dhe personal përgjatë gjithë periudhës së studimit si dhe lehtësimin e gjetjes së praktikave profesionale dhe përgatitjes së tyre për punësim.
6. Institucioni disponon të dhëna të plota statistikore vjetore lidhur me regjistrimet e studentëve, transferimet, çregjistrimet e tyre, studentët e mbetur në stazh dhe diplomimin.
7. Institucioni disponon të dhëna të plota për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi deri në diplomim, vlerësimet/notat e studentëve, statistika kalueshmërie si dhe notave mesatare në hyrje dhe dalje. Të gjitha të dhënat janë si në *hard copy* (ne regjistart përkatëse) ashtu dhe në formë elektronike.
8. Institucioni angazhohet si përmes njësisë bazë dhe stafit akademik, ashtu dhe me anë të ZKMS-së në informimin e studentëve rreth tregut të punës dhe për ndërmjetësimin në procesin e zhvillimit të praktikës profesionale.

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

10. Kërkimi shkencor

Pjesa përshkimore

Terma reference: politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

Siç vërehet në Planin Strategjik të Zhvillimit Institucional 2017-2022, Kërkimi Shkencor dhe Inovacioni përbëjnë një nga objektivat strategjik të institucionit ku në objektivat afatmesme evidentohet qartë nevoja për konsolidimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të strukturave të kërkimit shkencor si dhe zyrës së Koordinimit të Kërkimit shkencor dhe Botimeve akademike si dhe Komisionit për kërkimin shkencor dhe botimin.

Institucion ka të ngritur Zyrën e Koordinimit të Kërkimit shkencor dhe Botimeve akademike por që ka më shumë rol koordinues të veprimtarisë kërkimore sesa një implikim të drejtpërdrejtë me kërkimin shkencor. Roli kryesor për Kërkimin Shkencor i jepet njësisë bazë, siç dhe sanksionohet në vetë "Rregulloren mbi organizimin dhe funksionimin e Departamentit të Arkitekturës", ku shprehet që pjesë e misionit (Neni 3) dhe objektiveve (Neni 5) të kësaj njësie është nxitja, programimi, zhvillimi dhe organizimi i veprimtarisë kërkimore shkencore për programet që ofron.

Në bazë dhe të RVB, veprimtaria kërkimore shkencore e Departamentit të Arkitekturës bazohet në:

- realizimin e kërkimit shkencor nga stafi akademik;
- mbështetjen e veprimtarisë së stafit akademik;
- integrimin e kërkimit shkencor në mësimdhënie;
- transmetimin e metodave kërkimore shkencore tek studentët.

Nga verifikimet e bëra (Aneksi "6.3.b Raporti vjetor i departamentit të arkitektures për v.a 2017-2018.pdf" i DVV) rezulton që njësisë bazë bën çdo vit një vlerësim final të punës kërkimore bazuar në një sërë kriteresh si pjesëmarrja në konferenca apo realizimi i botimeve shkencore si dhe bën një përmbledhje të të gjithë aktiviteteve të bëra.

Në takimet me drejtuesit e Departamentit dhe Zyrën e Koordinimit të Kërkimit shkencor dhe Botimeve Akademike, është referuar që çdo fillim viti bëhet një planifikim i veprimtarive kërkimore dhe planifikim financiar për këto aktivitete në nivel njësisë bazë të cilat i kalohen komisionit për kërkimin shkencor, i cili jep miratimin paraprak për kalimin e mëtejshëm në miratimin e Senatit.

Është detyrim/traditë për të gjitha departamentet zhvillimi/pjesëmarrja në 1 konferencë studentore dhe 1 konferencë kombëtare/ndërkombëtare. Departamentit, dhe me asistencën e NjSBC, i përcillet në fund të çdo viti një formular që plotësohet nga çdo pedagog së bashku me një dosje (e cila arkivohet dhe pasurohet vazhdimisht për çdo pedagog) certifikatat, publikimet apo dëshmi të tjera që vërtetojnë punën kërkimore.

Gjatë takimit me stafin, është konfirmuar që Albanian University mbështet kërkimin shkencor të personelit akademik për publikime në revistën periodike "OPTIME", e cila përmban shkrime shkencore të personelit akademik të Albanian University apo dhe jashtë saj.

Ajo që bie në sy është pjesëmarrja jo shumë e lartë e Departamentit në projekte kërkimi/zhvillimi. Një nga synimet që Institucioni dhe Departamenti i Arkitekturës ekspozon është dhe rritja e aplikimeve në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, ku nëse vërehet që departamenti nuk ka kapacitete shkruese, atëherë institucioni lehtëson këtë proces me angazhimin e një kompanie të specializuar në shkrimin e projekteve me të cilën kanë dhe një marrëveshje zyrtare.

GVJ është i vetëdijshëm që cikli dhe natyra e programit nuk lejon një komponent të fortë "shkencor", megjithatë shikohet një angazhim i studentëve në këtë proces, kryesisht në pjesën e diplomës.

Ndërgjegjësimi i stafit akademik për rëndësinë e përfshirjes në veprimtari kërkimore-shkencore dhe nxitja e tij për zhvillimin e kërkimit shkencor dhe pjesëmarrjen në projekte kombëtare apo ndërkombëtare duhet të mbetet në vëmendje të vazhdueshme të Departamentit, pasi do të kishte një

efekt tejet pozitiv si në rritjen e kualifikimit të stafit akademik ashtu dhe të nivelit të mësimdhënies dhe formimit të studentëve.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna për kërkimin shkencor (*Tabela 19 e Aneksëve*)

Kërkimi shkencor dhe ai i aplikuar (duke parë natyrën e programit) zhvillohet nëpërmjet një sërë aktiviteteve si konferenca shkencore kombëtare/ndërkombëtare, projekte kërkimore, workshope, ekspozita, publikime, etj.

Vizita në institucion konfirmoi aktivitetin botues në revistën periodike "OPTIME", e cila përmban shkrime shkencore të personelit akademik të Albanian University, megjithatë nga shqyrtimi i të dhënave të raportuara në RVB konstatohet një numër jo shumë i lartë i botimeve (5 publikime në vitin akademik 2017-2018 dhe 2018-2019 nga stafi akademik efektiv në BSc në Dizajn). Nuk rezultojnë ndërkohë projekte kërkimore të fituara, kurse pjesëmarrja në projekte raportohet në 2 projekte individuale.

Evidentohet nga ana tjetër një organizim i gjerë i aktiviteteve nga IAL për BSc në Dizajn me 18 të tilla (jo të gjitha me karakter të mirëfilltë shkencor) në forma që shkojnë nga ekspozita, workshope, leksione të hapura apo vizita studimore e deri të konferenca shkencore (4 të tilla). Si rezultat konstatohet dhe një pjesëmarrje e gjerë në këto aktivitete me 575 të raportuara (prezenca në njerëz në aktivitetet e organizuara si ekspozita, workshope, leksione të hapura apo vizita studimore e deri në konferenca shkencore). Kërkimi shkencor në procesin mësimor është më shumë i lidhur me zhvillimin e diplomave (15 në vitin e fundit) dhe përfshirja e studentëve në kërkimin shkencor është më e reduktuar, fakt i mirëkuptueshëm për shkak të natyrës dhe ciklit të programit.

Të dhënat mbi veprimtarinë kërkimore për stafin në veçanti, raportohen, vlerësohen dhe arkivohen për çdo pedagog nga Departamentet, Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë, etj dhe bëhen pjesë e raporteve/vlerësimeve të njësive përkatëse.

GVI vlerëson që ka një numër të mirë organizimi aktiviteteve dhe pjesëmarrje në to, çka duhet mbajtur dhe mundësisht stimuluar më tej. Gjithsesi, ndërgjegjësimi dhe nxitja e stafit akademik në përfshirjen në projekte kombëtare/ndërkombëtare dhe publikimi i artikujve/monografive jo vetëm që do sillte një rritje të kualifikimit të stafit akademik por dhe të nivelit të mësimdhënies, aq më tepër në kushtet e vetëdijes së mangësisë së teorisë/literaturës në këtë fushë në gjuhën shqipe. Një zhvillim në këtë drejtim mund të sillte potencialisht dhe një përfshirje më të madhe të studentëve në kërkimin shkencor.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Gjatë vizitës në institucion janë verifikuar të dhënat e DVV si dhe janë marrë/parë dokumenta përfshirësi si botime që vërtetojnë publikimet (periodiku "OPTIME"), listë prezenca në aktivitete, formular mbi raportimin e kërkimit shkencor, dosje të arkivuar të aktivitetit shkencor të stafit (Stafit S. N.)

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkrimore

Terma reference: bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

Nga raportet e marra, Departamenti i Arkitekturës ka një marrëveshje bashkëpunimi me 6 institucione qeveritare si dhe 9 IAL brenda dhe jashtë vendit, me qëllim kryesor atë të shkëmbimit të kapaciteteve dhe burimeve njerëzore dhe materialeve/dokumentave, organizimin e aktiviteteve kërkimore apo aktiviteteve të tjera si konferenca, workshope, trajnime, leksione të hapura, ekspozita, etj.

Evidentohet gjithashtu një bashkëpunim i ngushtë me një sërë aktorësh lokalë nga fusha e tregut, më konkretisht 26 biznese të lidhura me profilin e programit të studimit me qëllim zhvillimin e praktikave profesionale, mësimore dhe laboratorike. Njëherazi ky bashkëpunim shërben dhe në marrjen e inputeve të duhura për studimin e tregut si dhe mundësinë e punësimit të studentëve pas diplomimit.

Një bashkëpunim i gjerë dhe i diversifikuar ndikon pozitivisht në zhvillimin e programeve të studimit, stafit, studentëve, institucionit në përgjithësi. Lidhja me aktorët e tregut të punës (kompani te ndryshme) duket mjaft funksionale dhe me impakt në plotësimin e qëllimeve të marrëveshjeve, atë të kryerjes së praktikave profesionale të studentëve. Ndërkohë që një pjesëmarrje e ulët në projekte kombëtare/ndërkombëtare dhe një mungesë mobiliteti konsistent sugjeron që duhet punuar më shumë në drejtim të rritjes së bashkëpunimeve aktive me partnerë të tjerë, kryesisht nga fusha e arsimit të lartë.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar (*Tabela 20 e Aneksëve*)

Nga materialet e vëna në dispozicion, rezulton që Departamenti ka një sërë marrëveshjesh në kuadër të shkëmbimit të stafit apo studentëve apo punëve kërkimore.

Në bazë të shqyrtimit të të dhënave, gjatë periudhës 2017-2019 rezulton vetëm 1 pjesëmarrje në projekte ndërkombëtare. Në kuadër të bashkëpunimeve, raportohen gjithashtu 11 leksione/seminare me lektorë të huaj (bazuar në Aneksin 10.1 "Aktivitete të organizuara nga departamenti 2017-2019" në DVV). Numri i pjesëmarrësve në trajnime në fushën e kërkimit shkencor jashtë vendit raportohet gjithashtu vetëm 1 ndërkohë që pjesëmarrja në aktivitete shkencore jashtë IAL është në një shifër prej 27.

Ajo që bie në sy është mos ekzistenca e mobilitetit të studentëve, si refleksion i numrit të ulët të projekteve të përbashkëta shkëmbimi me universitete ndërkombëtare.

Gjatë takimit me Zyrën e Koordinimit të Kërkimit shkencor dhe Botimeve Akadematike, nëse vërehet që departamenti nuk ka kapacitete shkruese/aplikuese për projekte, atëherë institucioni lehtëson këtë proces me angazhimin e një kompanie të specializuar në shkrimin e projekteve me të cilën kanë dhe një marrëveshje zyrtare. Rritja e bashkëpunimeve dhe e aplikimeve në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare nga ana e stafit akademik dhe Departamentit mund të sjell rezultate të përgjithshme shumë pozitive.

GVJ gjykon që, siç dhe është evidentuar në objektivat afatmesme të Institucionit në Planin Strategjik të Zhvillimit Insitucional 2017-2022 të Albanian University, konsolidimin dhe zhvillimin e një zyre aktive dhe cilësore të Projekteve do të ndikonte pozitivisht institucionin dhe stafin akademik në përthithjen e projekteve kërkimore/zhvillimore apo shkëmbimi në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar (bilaterale, AKSHI, Horizon 2020, Erasmus + KA1/KA2, etj) duke ndikuar kështu në rritjen e kapaciteteve kërkimore, infrastrukturat kërkimore, financim alternativ e mbi të gjitha në rritjen e mobilitetit të stafit dhe të studentëve.

- Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë (Tabela 21 e Anekseve)

Në kuadër të këtij programi, Institucioni/Departamenti ka të lidhura një sërë marrëveshjesh me IAL si kombëtare ashtu dhe ndërkombëtare.

6 prej tyre janë me institucione qeveritare (Arkivi i Shtetit Shqiptar, IMK, MB, Bashkia e Tiranës, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave dhe Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit). Fokusi i këtyre marrëveshjeve është shkëmbimi i kapaciteteve dhe burimeve njerëzore, materialeve dokumentare si dhe mundësia e kryerjes së praktikave profesionale për studentët.

Nga të dhënat e RVB dhe Raportit Vjetor të Departamentit, rezultojnë gjithashtu dhe 9 marrëveshje me IAL shqiptare dhe të huaja si UPT, UT, Universiteti i Arteve, SW University "Neofit Rilski, UBT, Kolegji Universitar Qirjazi, Kolegji AAB, Kolegji Pjetër Budi, Universiteti i Padovës ku qëllimi në përgjithësi është shkëmbimi i personelit, puna kërkimore e përbashkët apo organizimi i aktiviteteve të përbashkëta (si Konferenca e 4-të Shkencore Ndërkombëtare: "Problemet dhe sfidat e transformimit të shoqërisë shqiptare drejt standardeve të BE-së" në bashkëpunim me UBT).

Një pikë mjaft e fortë është bashkëpunimi me organizata profesionale dhe me komunitetin e biznesit (rreth 26 së bashku), marrëveshje që jo vetëm ndihmojnë në zhvillimin e praktikës profesionale të studentëve por dhe për të marrë vazhdimisht feedback nga tregu i punës, si dhe për të lehtësuar punësimin e studentëve.

Në përgjithësi vërehet një numër marrëveshjesh mjaft i mirë me institucione qeveritare dhe IAL të tjera, i cili sugjerohet të zhvillohet/zgjerohet dhe më tej, kryesisht duke garantuar një bashkëpunim konkret dhe frytdhënës përtej aspektit të marrëveshjeve formale jo aktive. Kjo do të sillte potenciale më të mëdha jo vetëm të shkëmbimit të dijes por dhe të projekteve të kërkimit dhe të mobilitetit. Përsa i përket marrëveshjeve me tregun e punës, edhe nga inputet e marra nga studentët dhe raportet e punësimeve pas diplomimit, shikohet një impakt pozitiv në program, çfarë duhet mbajtur sa më konstant dhe nëse e mundur të zhvillohet dhe më tej me marrëveshje të tjera me kompani të lidhura me profilin e programit.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Gjatë vizitës në institucion janë marrë marrëveshjet e bashkëpunimit.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
VII - INSTITUCIONI GARANTON MARRËDHËNIE BASHKËPUNIMI, TË BRENDSHME DHE TË JASHTME	

Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të vet.

Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;

Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.

Nga takimet e bëra me njësitë drejtuese dhe stafin, rezulton së për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit rolin kryesor e ka njësia bazë, por duke marrë për bazë kërkesat, inputet dhe sugjerimet që vijnë si nga njësi të tjera si NjsBC, ZK, etj., ashtu dhe nga stafi dhe puna e tyre në grup.

Detyrat e stafit janë të përcaktuara qartë në rregulloret e institucionit, ato të njësive kryesore, rregulloret e njësive bazë apo të njësive të tjera bnda institucionit. Po ashtu raportimi, analizimi dhe marrja e masave përkatëse garanton një marrëdhënie të vazhdueshme dhe të frytshme. Në rastin e programit të studimit, ekzistenca e grupeve mësimore dhe grupeve të sigurimit të cilësisë brenda departamentit janë një evidencë e ndarjes së detyrave nga njëra anë por nga ana tjetër dhe e bashkëpunimit të gjerë në përmirësimin e vazhdueshëm të programit në të gjitha komponentët e tij.

Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.

Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve dëshmon së ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;

Kriteri 2 Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofrojnë;

Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkëpunim me punëdhënësit;

Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.

Institucioni ka vendosur marrëveshje bashkëpunimi dhe partneriteti (9) me Universitete homologe si të rajonit ashtu dhe evropiane. Këto marrëveshje kanë prodhuar një sërë aktivitetesh shkencore të përbashkëta dhe trajnime por më pak përsa i përket mobilitetit të stafit dhe studenteve apo pjesëmarrjes në projekte kërkimi/zhvillimi në nivel kombëtar/ ndërkombëtar.


Institucioni bashkëpunon ngushtë me komunitetin e biznesit dhe me institucione publike (të evidentuara 33 partnerë (27+6) të këtyre 2 kategorive). Këto bashkëpunime shkojnë nga shkëmbimi i burimeve njerëzore dhe dokumentare e deri të zhvillimi i praktikave profesionale për studentët e institucionit.

Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale (Aneksi 11.4 "Raport analitik i përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale për realizimin e praktikave" të DVV) ku për vitin e fundit akademik raportohet që studentët ishin të shpërndarë për zhvillimin e praktikave profesionale në 10 nga 26 bizneset që institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Institucioni dëshmon një frymë pozitive dhe bashkëpunuese ndërmjet stafit në hartimin dhe mbikëqyrjen e programit dhe më gjerë.

2. Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit, por konsolidimi dhe zhvillimi i mëtejshëm do të ndikonte pozitivisht institucionin dhe stafin akademik në përthithjen e projekteve kërkimore/zhvillimore apo shkëmbimin/mobilitetin në nivel kombëtar dhe ndërkombetar.
3. Institucioni ka një bashkëpunim të ngushtë dhe shumë funksional me një sërë aktorësh lokalë nga fusha e tregut të punës (26 biznese) të lidhura me profilin e programit të studimit me qëllim zhvillimin e praktikave profesionale, mësimore dhe laboratorike.



ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

I. ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA AKREDITIMI I PARË

I.1. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit:

- 1) Rekrutimi i stafit akademik me kualifikim në përputhje me lëndët/modulet specifike të programit të studimit;
- 2) Të garantohet përcaktimi i titullarëve të lëndëve me kualifikimin e duhur akademik sipas standardeve të kërkuara;
- 3) Të rritet stafi akademik efektiv për të siguruar shpërndarjen e ngarkesës mësimore nga ana sasiore dhe cilësore sipas standardeve të kërkuara.

I.2. Plotësimi i tyre nga Institucioni:

- 1) Për rekomandimin 1, Institucioni ka marrë hapa konkretë duke shpallur vende vakante e më tej rekrutuar pedagogë me kualifikimin në përputhje me lëndët/modulet specifike të programit të studimit (verifikuar nga materialet e DVV: “R.1 Procedurë rekrutimi v.a 2018-2019 (përpara fillimit të vitit akademik)”; “R.2 Procedurë rekrutimi v.a 2017-2018 (përpara fillimit të semestrit të dytë)”). Gjate viteve akademike 2017-2018 dhe 2018-2019, institucioni ka rekrutuar 2 pedagogë të profilit art, 2 pedagogë të profilit arkitekturë dhe 2 pedagogë të profilit gjuhësi, të angazhuar në përputhje me profilet përkatëse dhe specifikat e lëndëve (verifikuar nga materialet e DVV: “R.3 Lista e lëndëve ku angazhohen pedagogët e rekrutuar”. Nga shqyrtimi i kontratave, planeve mësimore, syllabuseve, CV-ve dhe takimet në institucion, gjykohet që ka një përputhje midis kapacitetit/eksperiencës/ekspertizës dhe lëndëve që mbulojnë stafi, duke përmbushur kështu rekomandimin.
- 2) Për rekomandimin 2, Institucioni raporton që ka hasur vështirësi në rekrutim për shkak të mungesës së pedagogëve me tituj akademik Prof. As dhe Prof. Dr. në fushen “arte” dhe “arkitekturë”. Për lëndët në të cilat ka hasur mungesë në treg të profesorëve me tituj akademik, titullarët e lëndëve janë në përputhje me Vendimin e Senatit Nr. 19/4, dt. 15.09.2017 (verifikuar nga materialet e DVV: “R.4 Vendim Senati Mbi titullarët e lëndëve”). Ky vendim, për programet e studimit ku është gjykuar që ka mungesë në treg për pedagogeve me tituj akademik, vendos që stafi akademik i Albanian University me gradën “Doktor i Shkencave” të shërbejë si titullarë lëndësh, duke njohur karakterin e përkohshëm të këtij vendimi dhe ngarkuar njësitë bazë për vijimin e marrjes së masave për zgjidhjen e problematikës. Nga shqyrtimi i kurrikulave në proces rezulton që titullarët e 5/23 (pa diplomën dhe praktikën profesionale) të moduleve kanë kualifikim të kategorisë Prof., ndërsa pjesa tjetër ka gradën Dr. Duke marrë parasysh ciklin dhe veçorinë e programit si dhe vështirësitë objektive për gjetjen e stafin akademik me tituj në profilet specifike, pa mohuar rëndësinë e vijimit të rekrutimit të stafit me tituj si dhe stimulimin e stafit aktual për fitimin e kualifikimeve të mëtejshme, gjykojmë që rekomandimi është kryesisht i përmbushur në raport me kohën.

- 3) Për rekomandimin 3, institucioni, nga pikëpamja cilësore, gjatë viteve akademike 2017-2018 dhe 2018-2019 ka rekrutuar 5 pedagogë efektivë të angazhuar, të profilit në programin e studimit Bachelor në "Dizajn", 4 pedagogë me gradë Dr. dhe 1 MSc. Nga pikëpamja sasiore, numri i pedagogëve të angazhuar në programin e studimit Bachelor në "Dizajn", në vitin akademik 2017-2018, është 19, ku rreth 73% e ngarkesës vjetore u mbulua nga pedagogët efektivë, ndërsa në vitin akademik 2018-2019, numri i pedagogëve të angazhuar është 14, ku rreth 74% e ngarkesës vjetore u mbulua nga pedagogët efektivë. Shpërndarja e ngarkesës mësimore të stafit akademik është në përputhje me Vendimin e Senatit Nr. 46, dt 28.09.2018 dhe Nr. 19/5, datë 15.09.2017 ku vendoset që ngarkesa mësimore e stafit akademik të jetë në përputhje me nevojat e njësive bazë përkatëse. Duke u bazuar në ngarkesat mësimore të 2017-2018, 2018-2019 dhe planin e 2019-2020, në vendimet dhe udhëzimet në fuqi për ngarkesën mësimore të stafit në IAL gjykojmë që, edhe pse mund të përmirësohet më tej pasi ka një pjesë të stafit PAE që janë me orë suplementare po brenda normave, ky rekomandim është i përmbushur nga institucioni.

II. ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS - PIKAT E FORTA, WEAKNESSES - PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES -MUNDËSITË, THREATS - PENGESAT)

a. Pika të forta:

1. Programi i studimit BSc në Dizajn është i hartuar në përputhje me strategjinë e zhvillimit të institucionit dhe adreson nevojat e tregut të punës duke qenë i hartuar në përputhje me nivelin e studimit dhe me objektiva formimi të qarta.
2. AU ka një sistem të organizuar dhe funksional të sigurimit të brendshëm të cilësisë në disa nivele i cili mundëson një monitorim dhe përmirësim të vazhdueshëm të programit të studimit.
3. Institucioni ofron laboratore dhe ambiente mësimi dhe studimi të bollshme në shërbim të programit të studimit.
4. Një aspekt pozitiv i konstatuar është vetëdija dhe puna e stafit për integrimin e metodave "alternative" të mësimdhënies si dhe një raportim i ekuilibruar i njohurive teorike me aftësitë praktike.
5. Numri jo shumë i lartë i studentëve dhe sasia e lartë e praktikave mësimore garanton një marrëdhënie dhe komunikim të ngushtë pedagog-student.
6. Vërehet një rritje e numrit të studentëve të regjistruar dhe një nivel në hyrje i kënaqshëm.
7. AU ka ngritur një rrjet funksional dhe të gjerë partnerësh nga tregu i punës. Kjo mundëson jo vetëm zhvillimin e praktikave profesionale për studentët por shërben dhe si burim informacioni për përmirësimin e kurrikulës, organizimin e aktiviteteteve si dhe më e rëndësishmja integrimin e studentëve në tregun e punës.
8. Departamenti zhvillon një numër të lartë aktivitetesh kurrikularë dhe ekstra kurrikularë për programin e studimit ku vërehet një aktivizim i mirë i studentëve.

b. Pika të dobëta:

1. Mungesa në përgjithësi e stafit akademik me tituj dhe grada në fushën e dizajnit ka bërë që ky fakt të reflektohet dhe në stafin e angazhuar në programin e studimit.

2. Institucioni, megjithëse në nivel politikash tregon një përkushtim ndaj kërkimit shkencor, këto politika nuk reflektohen në një portfolio shumë të gjerë apo të njëtrajtshëm të përfshirjes së stafit në projekte/veprimtari kërkimore-shkencore apo publikime të artikujve shkencorë dhe monografive.
3. Institucioni, ka një sërë marrëveshjesh në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar por vërehet që përgjithësisht nuk janë aktive e kryesisht pa ndikim në nivel programor duke ndikuar në një përfshirje të ulët të “programit” (stafit apo studentëve) në projektet e ndryshme kërkimore/zhvillimore/shkëmbimi në bashkëpunim me institucione kombëtare dhe ndërkombëtare.

c. Mundësitë:

1. Kërkesa në rritje për këtë lloj profesioni, në vend, rajon dhe nivel botëror, e konfirmuar nga studimet e tregut.
2. Marrëveshjet e bashkëpunimit për zhvillimin e praktikave profesionale dhe një nivel i mirë i punësimit të të diplomuarve në këto partnerë falë këtyre praktikave mund të nxisë interesin e aplikantëve për të përzgjedhur të vazhdojnë studimet në këtë program studimi.
3. Përqëndrimi i Departamentit të Arkitekturës vetëm në fushën e Dizajnit dhe Dizajnit të Interierit mund të ndikojë pozitivisht në profilizimin e tij në këto disiplina si dhe në përmiresimin e vazhdueshëm të programit mesimor të BSc në Dizajn apo zgjerimin e profileve në këtë fushë duke ofruar specializime të ndryshme dhe thellim të mëtejshëm.

d. Pengesat:

1. Rënia demografike në nivel kombëtar si dhe rënia e numrit të aplikantëve në IAL në Shqipëri në tërësi, mund të prekë edhe numrin e të regjistruarve në këtë program studimi, pavarësisht se treguesit aktual tregojnë një rritje shumë të mirë.
2. Nëse përqëndrimi i Departamentit të Arkitekturës në Dizajn nga njëra anë përbën një mundësi, nga ana tjetër mund të përbëjë një risk për nënvlerësimin e programit në rang institucioni apo uljen e ndërveprimit me disiplina të ngjashme si arkitektura, qoftë në nivel oferte akademike apo “shkëmbimi” stafi duke ndikuar potencialisht dhe në rritjen e ngarkesës së stafit aktual.
3. Akreditimet me kohëzgjatje të shkurtër mund të përçojnë imazhin e një programi jo të qëndrueshëm dhe të konsoliduar, duke cënuar imazhin e tij e si pasojë kërkesën.
4. Për shkak të profilit shumë specifik, vërehet në “treg”mungesa e pedagogëve me grada dhe tituj shkencor në fushën e artit dhe dizajnit.
5. Mungesa e literaturës bashkëkohore në gjuhën shqipe në fushën e Dizajnit.

Rekomandime:

1. Duke njohur vështirësitë objektive për gjetjen e stafit akademik me tituj në profilet specifike, gjykohet gjithësesi e rëndësishme dhe e domosdoshme vijimi i rekrutimit të stafit me tituj dhe grada si dhe nxitja dhe mbështetja e stafit aktual për fitimin e kualifikimeve të mëtejshme.
2. Pavarësisht ciklit të programit të studimit, gjykohet si e rëndësishme nxitja, mbështetja dhe ndërgjegjësimi i stafit akademik për përfshirje dhe rritje në/të projekteve/veprimtarive kërkimore-shkencore dhe publikimin e artikujve shkencorë/monografive. Kjo jo vetëm që

do sillte një rritje të kualifikimit të stafit akademik por dhe të nivelit të mësimdhënies, rritjen e mundësive për përfshirjen e studentëve në kërkim si dhe një kontribut me vlerë në rritjen e teorisë/literaturës në këtë fushë në gjuhën shqipe.

3. Rekomandohet nxitja për rritjen e përfshirjes në projekte kombëtare/ndërkombëtare kërkimi/zhvillimi/shkëmbimi. Rritja dhe konsolidimi i marrëdhënieve të bashkëpunimit me institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit do të ndikonte pozitivisht institucionin dhe stafin akademik në përthithjen e projekteve kërkimore/zhvillimore apo shkëmbimin/mobiliteti (bilaterale, AKSHI, Horizon 2020, Erasmus + KA1/KA2, etj). Konsolidimi i njësisë përgjegjëse për bashkëpunimet dhe projektet do të ndikonte gjithashtu pozitivisht institucionin dhe stafin akademik në përthithjen e projekteve të tilla. Rritja e pjesëmarrjes në projekte të tilla do ndikonte në kualifikimin e stafit akademik, nivelit të mësimdhënies, rritjen e kapaciteteve kërkimore, infrastrukturat kërkimore, financim alternativ e mbi të gjitha në rritjen e mobilitetit të stafit dhe të studentëve.
4. Studentëve u janë vënë në dispozicion një sërë titujsh të literaturës përmes bibliotekës së institucionit por dhe bibliotekave online, por, nevojat specifike të programit të studimit dhe zhvillimi i vazhdueshëm i natyrës së këtij profesioni kërkon përditësimin e vazhdueshëm të kapaciteteve duke përditësuar vazhdimisht jo vetëm arkivën e bibliotekës, por edhe duke u abonuar në periodikë të fushave specifike të dizajnit.

III. SUMMARY ANALYSIS OF THE EER - SWOT METHOD (STRENGTHS, WEAKNESSES, OPPORTUNITIES, THREATS)

a. Strengths:

1. The study program BSc in Design is designed in line with the institution's development strategy and addresses the needs of the labor market by being designed in line with study level and with clear training objectives.
2. AU has an organized and functional internal system of quality assurance at several levels which enables continuous monitoring and improvement of the study program.
3. The institution offers the necessary laboratories and teaching and studying facilities for the study program.
4. A positive aspect noted is the consciousness and the staff work for the integration of "alternative" teaching methods and a balanced ratio of theoretical knowledge with practical skills.
5. The not so high number of students and the high amount of teaching practices guarantees a close teacher-student relationship and communication.
6. There is an increase in the number of enrolled students and a good entry level.
7. AU has established a functioning and extensive network of labor market partners. This enables not only the development of professional internships for students but also serves as a source of information for the curriculum improvement, organization of activities and most importantly for the integration of students into the labor market.
8. The Department develops a high number of curricular and extra curricular activities for the study program where a satisfactory student involvement is observed.

b. Weaknesses:

1. The general lack of academic staff with academic titles in the field of design has made this fact reflected in the staff engaged in the study program.

2. The institution, although at a policy level demonstrates a commitment to scientific research, these policies are not reflected in a very broad or uniform portfolio of staff involvement in research projects / activities or publication of scientific articles and monographs.
3. The institution has a number of agreements at national and international level which are not generally very active and mostly without impact on a study program level, affecting so a low involvement of the "study program" (staff or students) in various research / development / exchange projects in cooperation with national and international institutions.

c. Opportunities:

1. The growing demand for this type of profession, domestically, regionally and globally, confirmed by market studies.
2. The cooperation agreements for the development of professional internships and a good level of graduate employment in these partners thanks to these internships may stimulate applicants' interest in enrolling in this study program.
3. The focus of the Department of Architecture only in the field of Design and Interior Design can positively influence its profiling in these disciplines as well as the continuous improvement of the BSc in Design curriculum or the expansion of profiles in this field by offering various specializations and further education.

d. Threats:

1. The demographic "decline" at a national level as well as the decline in the overall number of HEI applicants in Albania may also affect the number of enrolled in this study program, despite current indicators showing a very good increase.
2. If the focus of the Department of Architecture on Design on one hand is an opportunity, on the other it may pose a thread of underestimating the program on an institutional level or reducing interaction with similar disciplines like architecture, either at the academic offer level or staff "exchange", potentially affecting and increasing the current staff load.
3. Short-term accreditations can convey the image of a non-sustainable and consolidated program, affecting its image and consequently the enrollment request.
4. Due to the very specific profile, there is a lack of academic staff with scientific/academic titles in the field of art and design.
5. Lack of contemporary Albanian literature in the field of Design.

Recommendations:

1. Being aware about the objective difficulties on finding academic staff with scientific/academic titles in the specific profile, it is nevertheless important and necessary to continue recruiting staff with such titles as well as encouraging and supporting current staff to gain further qualifications.
2. Regardless of the study program cycle, it is evaluated as important to encourage, support and raise the awareness of academic staff for the inclusion/ increase in/of research projects / activities and publication of scientific articles / monographs. This would not only increase the qualification of the academic staff but also the level of teaching, increase the opportunities for student involvement in research as well as a valuable contribution to the growth of theory / literature in this field in the Albanian language.

3. It is recommended to promote and increase the participation in national / international research/ development/ exchange projects. The enhancement and consolidation of cooperation agreements with counterpart institutions at national and international level would positively impact the institution and academic staff on the acquisition of research / development or exchange / mobility projects (bilateral, AKSHI, Horizon 2020, Erasmus + KA1 / KA2, etc.).

The consolidation of the responsible unit for collaborations and projects acquisition would also positively impact the institution and the academic staff on the absorption of such projects.

Increasing participation in such projects would affect the qualification of academic staff, teaching levels, research capacity building, research infrastructures, alternative funding, and above all, increasing the mobility of staff and students.

4. Students have access to a range of literature titles through the institution's library and online libraries, but the specific needs of the study program and the continuous development of the nature of this profession require constant updating of capacities by constantly updating not only library archives, but also subscribing to periodicals of specific design areas.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. PhD Elvan Dajko

2. PhD Saimir Kristo

